

**KONTRATË KONÇESIONI
PËR DHENIEN ME KONÇESION TE
MENAXHIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES DHE PERMIRESIMIT TEKNIK TE
TERMINALIT TE KONTEINEREVE NE PORTIN E DURRESIT**

Tiranë 22 Qershor 2011

MINISTRIA E PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT

DHE

BASHKIMI I PERKOHSHEM I SHOQERIVE:

DURRES KURUM SHIPPING SH.A.

GLOBAL LIMAN ISLETMELERI A.S.

Permbajtja

Nr. Titulli

Nenet

1. Perkufizimet dhe interpretimet
2. Koncesioni
3. Angazhimet e paleve
4. Sigurimi kontrates
5. Pronesia intelektuale
6. Njezia e zabtimit te projektit
7. Data efektive e kontrates
8. Ceshtje financiare
9. Koncesionari dhe Shoqeria koncesionare
10. Nenkontraktimi dhe transferimi i te drejtave
11. Sigurimi
12. Shfrytezimi dhe mirembajtja e koncesionit
13. Te drejta, detyra dhe detyrime te pergjithshme
14. Forca madhore
15. Rastet e Mospermbushjes
16. Zgjdhja e kontrates se koncesionit
17. Penalitetet dhe demet
18. Transferimi i TKD ne perfundim te periudhes se koncesionit
19. Mjetet e riparimit/ demshperblimet kumulative
20. Zgjdhja e mosmarreshjeve
21. Dispozita te ndryshme

ANEKSET

Aneksi I..... Kerkesat e Autoritetit (Dokumentat e Procedures konkuruese
të publikuara me 27.9.2010)

Aneksi II..... Oferta e Konçesionarit (Dokumentet e Ofertes së paraqitur të datës
25/11/2010 në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit

Aneksi III.....Planimetria 1 Harta e Terminalit Egzistues te Koneinereve
Planimetria 2 Harta per zgjerimin e Terminalit Pozicioni gjeografik

Aneksi IV..... Tarifat e sherbimeve portuale Asetet e portit

Aneksi V.....Lista e personelit egzistues ne teminalin e koneinereve.

Aneksi VI.....Sigurimi i Kontrates

**KONTRATE KONÇESIONI
PER
DHENIEN ME KONÇESION TE
MENAXHIMIT, OPERIMIT, MIREMBAJTJES DHE PERMIRESIMIT TEKNIK TE
TERMINALIT TE KONTEINEREVE NE PORTIN E DURRESIT**

KJO KONTRATE KONÇESIONI ne lidhje me menaxhimin, operimin, mirembajtjen dhe permiresimin teknik te terminalit te konteinereve ne Portin e Durresit, lidhet sot ne date 22/06/2011, ne Tirane, ndermjet:

(1) MINISTRISE SE PUNEVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT te Republikes se Shqiperise, qe vepron ne perputhje me Ligjin nr. 9663, date 18.12.2006 "Per konçesionet", i ndryshuar, Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 546, date 28.05.2009 "Per miratimin e masterplanit per zhvillimin e Portit te Durresit", Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 27, date 19.01.2007 "Mbi miratimin e rregullave per vleresimin dhe dhenien e koncesioneve", i ndryshuar dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 303, date 28.04.2010 "Per percaktimin e autoritetit kontraktues, per ndertimin me koncesion te terminalit te konteinereve ne Portin e Durresit dhe miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkurrese qe i jepet shoqerise "Dures Kurum Shipping Sh.A" si dhe sipas Marreveshjes date 31.08.2009 nenshkruar midis Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise, i perfaqesuar nga Ministri i Puneve Publike dhe Transportit Z. Sokol Olldashi dhe Dures Kurum Shipping Sh.A ("MPPT" ose "Autoriteti Kontraktues");

DHE

(3) BASHKIMIT TE SHOQERIVE ("Konçesionari") te krijuar nga:

DURRES KURUM SHIPPING SH.A., nje shoqeri aksionare, e krijuar dhe themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, regjistruar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit me NUIS [J 61811539M, sipas vendimit te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 4636, me date 26/05/1993 me seli ne adresen: Kantjerin Detar, Porti i Durrësit, Durrës.

GLOBAL LIMAN ISLETMELERI A.S., nje shoqeri aksionare, e krijuar dhe themeluar sipas ligjeve te Republikes se Turqise, regjistruar ne Regjistrin Tregtar te Stambollit me nr. 521332, datë 20.04.2004, me seli ne adresen: Rihtim Caddesi, No:51, Karaköy, 34425, Istanbul, Turkey.

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do te referohen individualisht si "**Paia**" dhe bashkerisht si

“Palet”.

DEKLARIME PARAPRAKE:

- A. Autoriteti Kontraktues ka tagrat te nenshkruaje kete kontrate ne perputhje me:
- Ligjin nr. 9663, date 18 .12.2006 “Per konçesionet”, i ndryshuar;
 - Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 27, date 19.01.2007 “Mbi miratimin e kriterëve te vleresimit ne lidhje me dhenien e koncensioneve”, i ndryshuar;
 - Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 303, date 28.04.2010 “Per percaktimin e autoritetit kontraktues, per ndertimin me koncesion te terminalit te konteinereve ne Portin e Durresit dhe miratimin e bonusit ne proceduren perzgjedhese konkurruese qe i jepet shoqerise Durres Kurum Shipping Sh.A”;
 - Ligjin nr. 9251, date 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikes se Shqiperise”, i ndryshuar;
 - Ligji nr. 9130, date 08.09.2003 “Per autoritetet portuale”;
 - Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 546, date 28.05.2009 “Per miratimin e masterplanit per zhvillimin e Portit te Durresit”;
 - Marreveshjen date 31.08.2009, nenshkruar midis Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise, i perfaqesuar nga Ministri i Puneve Publike dhe Transportit Z. Sokol Olldashi dhe Durres Kurum Shipping Sh.A.
 - Kerkesen per Propozim dhe Udhezimet per Ofertuesit, (Dokumentat Standarte te Tenderit) 132, datë 22/09/2010, me ane te te cilave MPPT ka ftuar ofertuesit te paraqesin ofertat e tyre menaxhimin, operimin, mirembajtjen dhe permiresimin teknik te terminalit te konteinereve ne Portin e Durresit;
 - Legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- B. Me date 25/11/2010, ora 12.00., Konçesionari ka paraqitur propozimin e tij ne lidhje me kete procedure konkurruese (“Oferta e Konçesionarit”) qe eshte pranuar nga Autoriteti Kontraktues;
- C. Me date 28/12/20010 Autoriteti Kontraktues i ka derguar Konçesionarit “Njoftimin e Fituresit”, (Dokumenti nr. 5255/3 prot.), Negociatat per negociimin e Kontrates u hapen zyrtarisht ne date 20.04.2011
- D. Kjo Kontrate Konçesioni do te hyje ne fuqi pas miratimit te saj nga Keshilli i Ministrave dhe Publikimit ne Fletoren Zyrtare (“Data Efektive”);
- E. Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari angazhohen ne mirebesim te vene ne zbatim kete Kontrate Koncesioni ne perputhje me afatet dhe kushtet e parashikuara me poshte;
- F. Konçesionari, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga Data Efektive do te themeloje nje shoqeri tregtare (“Shoqeria Konçesionare”), te ciles do t’i transferohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Konçesionarit sipas kesaj Kontrate.

DUKE PASUR PARASYSH sa me siper, Palet bien dakord si me poshte:

5

1. PERKUFIZIMET DHE INTERPRETIMET

1.1 Perkufizimet

Kurdohere qe fjaltet me germen e pare te madhe do te perdoren ne kete Kontrate (duke perfshire edhe Anekset e saj), keto fjale do te kene kuptimet e meposhtme:

“Aktet Korruptive” do të thotë akti i premtimit, i dhënies, i marrjes ose i marrëveshjes për të marrë para ose ndonjë send tjetër me vlerë, me qëllim korruptimi ose që perceptohet si korruptim, për të ndikuar tek një punonjës publik në kryerjen e detyrave të tij shtetërore si dhe aktet që sjellin përgjegjësi penale sipas Kodit Penal Shqiptar.

“Aneks” do te thote çdo shtojce e kesaj Kontrate qe formon nje pjese integrale dhe te pandare te saj.

“Autoritet Kontraktues” do te thote “Ministria e Puneve Publike dhe Transportit e Republikes se Shqiperise” ose shkurt “MPPT” si dhe çdo institucion tjetër te cilit mund t’i kalojne ne kohe te drejtat dhe detyrimet e kesaj Kontrate.

“Autoriteti Portual Durres ose APD” do te thote personi juridik i cili perfaqeson interesin publik dhe administron pronen publike te Portit te Duresit, i krijuar sipas ligjit 9310, date 08.09.2003 “Per autoritetin portuale” dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 596, date 10.09.2004 “Per miratimin e statutit te Autoritetit Protual Durres dhe riorganizimin e tij”, i ndryshuar.

“Data Efektive” ka kuptimin e percaktuar ne Piken (E) te Kushteve Paraprake dhe Nenin 7 te kesaj Kontrate.

“Data e fillimit të operimit” do të thotë data në të cilën koncesionari fillon operimin në TKD e cila nuk do të jetë më vonë se 6 muaj nga Data Efektive.

“Data e Paraqitjes se Ofertes” do te thote data dhe ora ne te cilen ofertuesit kane paraqitur ofertat e tyre per kete konçesion ne perputhje me Udhezimet per Ofertuesit.

“Dite Pune” do te thote nje dite gjate se ciles ne Republiken e Shqiperise punohet me perjashtim te te dielave dhe festave zyrtare.

“Dokumente Financuese” do te thote çdo marreveshje huaje, bono, kontrata, instrumente, marreveshje sigurimi, deklarata regjistrimi ose informimi, hipoteka, akte perfaqesimi e administrimi, marreveshje kredie, marreveshje per blerje bonosh, marreveshje pjesemarrjeje dhe dokumente te tjera qe lidhen nga Konçesionari dhe/ose Shoqeria Konçesionare ne lidhje me objektin e Konçesionit dhe per ushtrimin e te Drejtave Konçesionare, duke perfshire modifikimet, plotesimet, shtesat, zgjatjet, ripertitjet dhe zevendesimet e çdo instrumenti financimi.

“E Drejta e Kalimit” do te thote e drejta per te kaluar mbi dhe nen Port dhe ne çdo pjese te tyre si dhe per te hyre dhe per te dale ne te, pa nderhyrje te parregullt nga ndonje pale e trete me qellimin e zbatimit te kesaj Kontrate.

“Entitet Shteteror” do te thote (i) Keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise, dhe/ose çdo ministri, departament ose nenndarje politike dhe administrative e saj; dhe (ii) çdo gjykate ose instance gjyqesore ose çdo entitet tjetër qeveritar, agjenci ose autoritet nen kontrollin e Republikes se Shqiperise, ose çdo ministri, departament ose nenndarje politike e saj, si dhe çdo komune ose bashki, dhe qe ushtrojne juridiksion sipas Ligjeve te Republikes se Shqiperise mbi Konçesionarin, ose çdo autoritet i pavarur rregullator, ne territorin e

Republikes se Shqiperise. Autoriteti Kontraktues perjashtohet nga ky perkufizim

“Financues” do te thote çdo institucion i njohur financiar kombetar apo nderkombetar, i cili ne perputhje me veprimtarine e tij mund te financoje kete Konçesion bashke me Konçesionarin/Shoqerine Konçesionare.

“Force Madhore” ka kuptimin e percaktuar ne Nenin 16.

“Sherbimet e Projektit” do te thote menaxhimi, operimi, mirembajtja dhe permiresimi teknik dhe adaptimi per te permbushur kerkesat aktuale dhe te ardhshme te trafikut ne CTD duke perfshire ngarkimin dhe shkarkimin e anijeve konteinerike dhe aktivitetet e lidhura te tilla si depozitim konteineresh, magazinim, levizje ekstra, transportin, spontimi, marrjen dhe shpendarjen dhe perfshire marrjen e masave te burimeve te kerkuara per mjete, pajisje, sisteme, praktika, procedura, programe, organizim dhe burime njerezore ne perputhje me praktikat me te mira industriale dhe sic jane te specifikuar ne Termat e References (TeR)

“Institucione Financiare” do te thote çdo insitucion i njohur financiar, kombëtar ose nderkombetar i cili ne perputhje me aktivitetin e tij mund te financoje kete Konçesion se bashku me Konçesionarit/Shoqerine Konçesionare.

“Kodi ISPS ose ISPS” do te thote Kodi Nderkombetar i Sigurise se anijeve dhe ambienteve te porteve i cili perbehet nga nje sere masash per permiresimin e sigurise ne anije dhe ambientet e porteve.

“Kontrate Konçesioni” ose **“Kontrate”** do te thote kjo kontrate e shkruar e lidhur mes Paleve perfshire Dokumentat Standarde te shpalluara nga Autoriteti Kontraktuese, Oferten e Konçesionarit, te gjitha Anekset dhe formularet dhe dokumentat bashkengjitur, te cilet perbejne pjese integrale e te pandashme te saj pavaresisht emertimeve qe u jepen ne vijim te negociatave mes Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit.

“Konçesionar” do te thote bashkimi i shoqerive Durres Kurum Shipping Sh.A. dhe Global Liman Isletmeleri A.S. si dhe çdo person juridik tjetër ne kohe te cilit mund t'i kalojne te drejtat dhe detyrimet e kesaj Kontrate.

“Leje, Autorizim, Liçense” do te thote çdo miratim, leje, liçence, autorizim, aprovim ose çertifikate, nxjerrja ose ripertitja e seciles eshte ne pergjegjesine e çdo Entiteti Shteteror dhe qe kerkohet per zbatimin e kesaj Kontrate;

“Ligj” do te thote çdo ligj themelor, dekret, vendim i Keshillit te Ministrave apo çdo rregullore tjetër, , urdher, license, leje, autorizim, vendimet unifikuese te gjykatave, , ne ndryshimet qe mund te pesojne gjate kohezgjatjes se kesaj Kontrate.

“Mbyllje Financiare” do te thote data kur nenshkruhen Dokumentet Financuese qe mbulojne koston totale kapitale te investimit per Konçesionin dhe ato hyjne teresisht ne fuqi.

“Norme Inflacioni” do te thote norma zyrtare e inflacionit sipas perlllogaritjeve te Insittuti te Statistikave te Republikes se Shqiperise “INSTAT”-it

“Njoftimi per Zgjidhjen” ne lidhje me Autoritetin Kontraktues ose Konçesionarin, sipas rastit, do te thote nje njoftim i njeres Pale drejtuar Pales tjetër qe deklaronte se kjo Kontrate do te zgjidhet, sipas rastit, ne vijim: (i) te nje Rasti Mospermbushjeje nga Konçesionari ose te nje Rasti Mospermbushjeje nga Autoriteti Kontraktues, i cili nuk eshte permbushur brenda kuadrit kohor te parashikuar ne kete Kontrate, (ii) te Forces Madhore qe zgjat mbi 6 (gjashte) muaj, ose (iii) te çdo rasti tjetër te parashikuar shprehimisht ne kete Kontrate, i cili do te specifikojte shkaku e zgjidhjes dhe daten e zgjidhjes faktike te kesaj Kontrate, e cila do te jete jo me pare se tridhjetete (30) dite pas ketij njoftimi.

“Oferta e Konçesionarit” ka kuptimin e parashikuar ne Piken (B) te Deklarimeve Paraprake

te kesaj Kontrate.

“Periudha e Shfrytezimit dhe Mirembajtjes” do te thote periudha e kohes qe zgjat nga Data e fillimit të operimit dhe deri ne mbarimin te Periudhes Konçesionare.

“Periudhe Konçesionare” do te thote kohezgjatja prej 35 (tridhjetë e pese) vjetesh duke filluar nga Data Efektive, sic percaktohet ne nenin 2.4.

“Perfaqesuesi i Autoritetit Kontraktues” do te thote çdo perfaqesues qe mund te caktohet here pas here nga Autoriteti Kontraktues per ta perfaqesuar ne lidhje me kryerjen e ndonje prej te drejtave te tij sipas kesaj Kontrate, me kusht qe, nese do te linde ne vijim nevoja, Autoriteti Kontraktues te njoftoje menjehere Konçesionarin per cdo mbarim mandati, zevendesim ose nderrim perfaqesuesi.

“Permiresim Teknik” do te thote zhvillimi dhe permiresimi ose modernizimi teknik i infra-dhe superstruktures se TKD-se qe gjithsesi perfshin edhe financimin ne perputhje me Praktikate e Industrise se Mire me qellimin per te arritur kerkesat e tanishme dhe te ardhshme te perdoruesve te portit ne fasilite, produktivitet, eficience dhe kosto efektive lidhur me trafikun e anijeve dhe konteinereve.

“Praktike e Industrise se Mire” do te thote praktikate, metodat, standardet, procedurat dhe rekomandimet qe jane ne perputhje me Ligjet e zbatuara pergjithesisht ne sherbimet e ndertimit, reabilitimit, dhe shfrytezimit te koncensionit te terminalitet te konteinereve, , koncension i cili pritet ne menyre te arsyeshme te realizohet nga nje kontraktor i afte dhe me eksperience ne rrethana te njejta ose te ngjashme me praktika, metoda, standarde dhe procedura te cilat do te perfshijne, pa kufizim, standardet Shqiptare dhe Evropiane (cilado qofshin me te larta, nga nje periudhe kohore ne tjetren).

“Port” do te thote Porti i Durrësit.

“Produktiviteti Bruto” eshte koha e numrit te njesive konteinere, shkarkimi ose ngarkimi nga ose ne anije, te perpunuara nga nje brigade pune (working gang) per njesine e kohes, pergjithesisht e paraqitur si numri i konteinereve (boxes apo TEU) per brigade per turn apo per ore (gang/hour). Njesia e kohes (turn apo ore) perfshin te gjithe nderprerjet e punes dhe ndalesat. *(Per te shmangur çdo keqkuptim numri i brigadave te punes eshte i njejte me numrin e vinçave dhe anasjelltas).*

“Punime Mirembajtjeje” do te thote punimet qe duhet te kryhen nga Konçesionari per te siguruar mirembajtjen dhe funksionimin e duhur te TKD gjate gjithe Periudhes se Koncensionit.

“Shoqeri Konçesionare” do te thote nje shoqeri qe do te themelohet dhe funksionojë sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise .

“Takse” do te thote çdo takse, detyrim, tatim, tarife, pagese, takse doganore ose tarife e çdo lloji, e ngarkuar, e vene, e kerkuar, ose mbledhur, drejtperdrejt ose terthorazi, nga çdo Entitet Shteteror sipas Ligjit.

“TKD” do te thote Terminali ekzistues i Konteinereve ne Portin e Durrësit kalata 6, me mundësi zgjerimi sipas planimetrisë nr. 2, sipas Aneksit III bashkëlidhur.

“Standarte Shfrytëzimi” do të thotë Standartet ISO 9001:2008, ISO 14001, ISO 28000 dhe BS OHSAS 18001, sipas parashikimeve të Dokumentave Standarte.

“Vlera e Investimit” do te thote shuma totale (ne Leke) per kryerjen e investimit te nevojshem per realizimin e Infrastruktures dhe Sherbimeve te Projektit siç percaktohet ne Nenin 8.4

“Xhiro Vjetore” do te thote të ardhurat bruto vjetore që grumbullohen nëpërmjet mbledhjes

së tarifave të përpunimit të konteinerëve nga koncesionari në përputhje me legjislacionin në fuqi para pagesës së taksave në përputhje me legjislacionin shqiptar, e cila do të shërbej si bazë për përllogaritjes e tarifës koncesionare..

“Termet e References” janë Ankes i kesaj kontrate dhe permbajne fushen e objektit te veprimtarise qe kerkohet te kryehet nga Koncesionari sipas kesaj Kontrate.

1.2 Interpretimi

Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate:

- 1.2.1 Njejesi perfshin shumetin dhe anasjelltas;
- 1.2.2 Referimi tek njera gjini perfshin edhe gjinite e tjera;
- 1.2.3 Referimi tek personat fizike do te nenkuptoje edhe referimin tek personat juridike te çdo lloj forme organizimi ne kuptimin me te gjere te mundshem si dhe tek çdo lloj forme tjeter organizimi ne kuptimin me te gjere te mundshem qe nuk ka personalitet juridik;
- 1.2.4 Referimi tek nje ligj, vendim, rregullore, urdher apo procedure perfshin referimin tek ai ligj, vendim, rregullore, urdher apo procedure siç eshte/mund te jete ndryshuar, shtuar apo rimiruar kohe pas kohe dhe tek cdo akt tjeter i dale ne mbeshtetje e per zbatim te tyre.
- 1.2.5 Termi “ndertim” do te perfshije apo nenkuptoje proceset e investigimit, projektimit, prokurimit, dergimit, transportit, instalimit, perpunimit, fabrikimit, testimit, komisionimit si dhe procese te tjera te lidhura direkt apo indirekt me ndertimin;
- 1.2.6 Termet “te kesaj”, “ketu”, “nepermjet kesaj ose nga kjo”, “ne kete” dhe fjale te ngjashme i referohen Kontrates ne teresi dhe jo ndonje Neni, Paragrafi, Tabele, Aneksi ose Grafiku apo ndonje nenndarje tjeter te kesaj Kontrate;
- 1.2.7 Parathenia dhe Shtojcat, Tabelat dhe Anekset te kesaj Marreveshjeje do te perbejne pjese integrale te kesaj Marreveshjeje dhe referencat ne Shtojcat, Tabelat dhe Anekset do te jene referenca ne Shtojcat, Tabelat dhe Anekset e kesaj Kontrate, pervec kur Palet merren vesh ndryshe;
- 1.2.8 Çdo fraze qe fillon me fjalet “perfshin” ose “duke perfshire”, “ne vecanti”, “per shembull”, “te tilla si” apo te ngjashme, do te kuptohen si ilustruese dhe pa kufizim ndaj pergjithshmerise se fjaleve te pergjithshme te lidhura;
- 1.2.9 Referencat ne “kete Kontrate” ose “kjo Kontrate Konçesioni” do te interpretohen si referenca ne kete Kontrate siç mund te ndryshohet ose modifikohet ne kohe, si dhe do te perfshijne referencen ne çdo dokument qe e ndryshon, modifikon ose e shton ate, ose qe eshte lidhur, bere ose dhene ne zbatim ose ne perputhje me kushtet e saj;
- 1.2.10 Sa here qe kjo Kontrate i referohet nje numri “ditesh” ky numer do t’i referohet diteve kalendarike, pervec kur specifikohen si Dite Pune;
- 1.2.11 Çdo reference ne “muaj” ose “vit” do te interpretohet si reference ne nje muaj kalendarik ose ne nje vit kalendarik;
- 1.2.12 Cdo fjale, term, fraze dhe shkurtim qe fillon me shkronje te madhe e perdorur specifikisht ne ndonje Aneks, Bashkelidhje a Dokument tjeter bashkangjitur do te kete kuptimin e percaktuar ne kete Aneks, Bashkelidhje a Dokument, sipas rastit;
- 1.2.13 Titujt e perdorur per nenet, paragrafet, nenparagrafet, Anekset dhe tabela e permbajtjes jane vetem per lehtësi referimi dhe nuk do te ndikojne ne interpretimin e

kesaj Kontrate;

- 1.2.14** Ne rast mosperputhjeje midis çdo fjale me germe te madhe, termi te percaktuar, fraze ose shkurtimi te parashikuara ne Nenin 1.1 dhe nje dispozite, fjale me germe te madhe, termi, fraze ose shkurtimi parashikuar gjetke ne kete Kontrate, Aneks, Bashkelidhje ose ne nje Dokument tjetër bashkangjitur tek çdo Bashkelidhje, kuptimi i dhene ne Nenin 1.1 do te kete perparesi ndaj kuptimit te dhene ne çdo Aneks, Bashkelidhjeje a nje Dokument tjetër bashkangjitur çdo Bashkelidhjeje, perveç kur konteksti i kesaj Kontrate e kerkon ndryshe;
- 1.2.15** Nje referim tek nje ent shtetëror nenkupton referencen tek juridiksioni i tij dhe nese ky ent shtetëror:
- (i) zevendesohet nga nje organ/ent tjetër, atehere i referohet juridiksionit te ketij te fundit;
 - (ii) pushon se ekzistuari, atehere i referohet juridiksionit te organit/entit, i cili ka kompetenca te peraferta ose te njejta me organin/entin shtetëror qe ka pushuar se ekzistuari;
- 1.2.16** Kudo ne Kontrate dhe ne gjithë dokumentacionin bashkengjitur asaj, termi “Konçesionar” do te nenkuptoje njekohesisht edhe termin “Shoqeri Konçesionare” dhe anasjelltas;
- 1.2.17** Pa paragjykim ndaj paragrafeve te mesiperm, nese ka ndonje konflikt apo mosperputhje ndermjet neneve dhe Anekseve dhe/ose ndonje shtojce te Anekseve dhe/ose cdo dokumenti tjetër te cilit i referohemi ne kete Kontrate, konflikti apo mosperputhja do te zgjidhet sipas rendit te meposhtem te perparësisë, duke bere interpretimin me mirebesim, nisur nga qellimi qe kane patur Palet:
- (i) Kerkesat e Autoritetit Kontraktues (*Dokumentat Standarte te Tenderit*);
 - (ii) Oferta e Konçesionarit;
 - (iii) Kontrata Konçesionare, Anekset dhe cdo dokument tjetër bashkëlidhur;
 - (iv) Çdo dokument tjetër ku Kontrata Konçesionare bën referencë.
- Gjithashtu gjate interpretimit te kesaj Kontrate do te mbahen parasysh rregullat me poshte:
- (i) kur ka mosperputhje mes dy neneve te Kontrates do te kete perparesi neni qe rregullon ne menyre te posaçme çeshtjen e paqarte apo objekt mosmarreveshjeje;
 - (ii) kur ka mosperputhje mes dimensioneve te paraqitura ne projekte dhe dizenjo me dimensionet e shkruara, keto te fundit do te kene perparesi;
 - (iii) kur ka mosperputhje mes vlerave numerike te shprehura ne shifra dhe te paraqitura me fjale, këto të fundit do te kene perparesi.

Neni 2

Konçesioni

2.1 Objekti dhe vendndodhja e Konçesionit

- 2.1.1** Autoriteti Kontraktues, nepermjet kesaj Kontrate dhe ne perputhje me kushtet e saj, i jep Konçesionarit te drejten per menaxhimin, operimin, mirembajtjen, permiresimin teknik dhe pershtatjen per te perballuar kerkesat aktuale dhe te se ardhmen te

pershkruara ne Dokumentat Standarde, për terminalin e konteinerëve ne brenda territorit të Portit të Durrësit.

- 2.1.2 Zona në të cilën shtrihet ky konçesion (kalata 6) përcaktohet sipas vizatimeve dhe hartave bashkëngjitur kësaj Kontrate dhe përcaktimit në Masterplanin e miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 546, datë 28.05.2009. Shërbimet dhe çdo detyrim i Konçesionarit do të kryhen vetëm brenda kufijve të përcaktuar të Dokumentat Standarde. Çdo aktivitet jashtë kufijve të Dokumentave Standarde duhet të miratohet paraprakisht me shkrim nga Autoriteti Portual Durrës dhe për çdo sipërfaqe shtesë APD do të aplikojë pagesa qiraje konform masterplanit.

2.2 Ekskluziviteti

Autoriteti Kontraktues, nëpërmjet kësaj Kontrate i njeh Konçesionarit të drejtën ekskluzive për aktivitet terminal kontejnerësh në Gjirin e Durrësit.

2.3 Pranimi i Konçesionit

Konçesionari, nëpërmjet kësaj Kontrate dhe në përputhje me parashikimet e saj, pranon Konçesionin duke rënë dakord e duke marrë përsipër të zbatojë Projektin dhe Infrastruktura të Shërbimit e Projektit.

Konçesionari me shpenzimet, kostot dhe nën përgjegjësinë e tij do të menaxhojë, operojë, mirembajë, përmirësojë teknikisht dhe përshtasë terminalin për të përballuar kërkesat aktuale dhe të së ardhmes të parashikuara në Dokumentat Standarde, në lidhje me trafikun, përfshirë ngarkim-shkarkimin e anijeve të konteinerëve dhe aktiviteteve të tilla si depozitimi kontejnerësh, magazinim, levizje ekstra, transportim, kontroll, etj., dhe në fund të Periudhës Konçesionare do të transferojë Infrastruktura të Shërbimit e Projektit tek Autoriteti Kontraktues.

2.4 Periudha e Konçesionit

2.4.1

Konçesionin sipas kësaj Kontrate jepet për një periudhë prej 35 (tridhjetë e pesë) vitesh ("Periudha Konçesionare"), e cila fillon nga Data Efektive. Në rast se Konçesionin shtyhet nga Autoriteti Kontraktues, për shkak të parashikuara në këtë Kontratë, tej periudhës në vite të përcaktuara këtu me sipër, Periudha Konçesionare do të përfshijë edhe periudhën shtesë. Në rast se Konçesionin përfundon para periudhës në vite të përcaktuara këtu me sipër, për shkak të zgjidhjes së kontratës apo shkak të tjera që çojnë në përfundimin e saj, Periudha Konçesionare do të reduktohet/kufizohet në periudhën nga Data Efektive deri në datën e përfundimit të Konçesionit.

2.4.2 Periudha Konçesionare mund të shtyhet në rastet e mëposhtme:

- (i) në rastin e Forces Madhore, për një periudhë kohë të barabartë me kohën që ka zgjatur ngjarja e Forces Madhore dhe kohën e arsyeshme për riparimin e dëmeve të shkaktuara.

2.5 Deklarime dhe garanci të Paleve

2.5.1 Konçesionari deklaron dhe garanton se:

- (i) Konçesionari është i vetëdijshëm dhe pranon që ai nuk do të vendosë, aplikojë, zbatojë, vjele, imponojë ose kërkojë, në çdo lloj forme, pagesa, tarifa, taksa apo

pagesa te tjera te ndryshme te cilat percaktohen ne menyre ekskluzive nga Autoritetit Portual. Ne rast dyshimi, Konçesionari do te konsultoje Autoritetin Portual perpara se te llogarise, vendose, aplikojë, zbatojë, vjete, imponojë ose kerkojë pagesa te tilladhe vendimi i Autoritetit Portual në çdo rast është i detyrueshëm.

- (ii) Ka bërë dhe do te beje, kerkimet dhe studimet e veta per zbatimin dhe permbushjen e detyrimeve te tij te parashikuara ne kete Kontrate dhe se disponon te gjithë informacionin e vene ne dispozicion nga Autoriteti Kontraktues, dokumentet standarte dhe çdo lloj informacioni te kerkuar nga Konçesionari para Dates Efektive;
- (iii) Eshte ne dijeni te plote persa i perket permbajtjes dhe kerkesave te Autoritetit Kontraktues te percaktuar ne Aneksin I (“Dokumentat Standarte”) dhe Aneksin II (“Oferta e Konçesionarit”);
- (iv) Zoteron te gjithë informacionin, burimet financiare, pajisjet, sistemet dhe personelin e nevojshem, te duhur dhe te kualifikuar me qellim permbushjen e detyrimeve kontraktore;
- (v) Koncesionari duhet t’i kryejë Sherbimet dhe permbushe detyrimet e tij me te gjitha perpjekjet, eficiente dhe ekonomike ne pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuar ne pergjithesi dhe brenda kuptimit te “praktikes me te mire”. Koncesionari duhet te ndjeko praktikë ekonomike, racionale dhe efektive te biznesit dhe te perdore teknologji te avancuara dhe te pershtatshme si dhe metoda te sigurta.
- (vi) do te veproje gjithmone si nje partner loyal (i besueshem) i Autoritetit Kontraktues dhe do të ruajë gjithmonë interesin publik.
- (vii) do te ushtroje kujdes te plote ne marrëdhëniet me palet e treta duke perfshire median dhe nuk do te marre pjese apo kryejë veprime qe jane jashte kompetences se tij ne perfaqesimin e Autoritetit Kontraktues.
- (viii) Në asnjë rast nuk do të kërkojë ndonjë dëmshpërblim, penalitet apo nuk do të ngrejë çfarëdolloj pretendimi/padie në lidhje me zbatimin e Kontratës ndaj Autoritetit Kontraktues apo Enteve Shtetore të tjera, për fakte, rrethana apo ngjarje për të cilat ka dijeni;
- (ix) Konçesionari brenda 30 (diteve) nga Data Efektive do te themeloje nje shoqeri tregtare (“Shoqeria Konçesionare”), te ciles do t’i transferojë te gjitha te drejtat dhe detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate.
- (x) Koncesionari do të fillojë operimin brenda 6 muajsh nga data efektive. Gjatë kesaj periudhe, TKD do të operohet nga APD dhe tarifat e mbledhura do të jenë të ardhura të APD-së deri ne momentin kur TKD te filloje te operohet nga Koncesionari.
- (xi) Te gjitha kontratat qe do te lidhen nga Konçesionari me te trete nuk do te kene periudhe vlefshmerie me te gjate se 3 (tre) muaj pas perfundimit te Periudhes Konçesionare.
- (xii) Eshte themeluar dhe organizuar ne menyre te vlefshme ne perputhje me Ligjin si dhe gezon te gjitha tagrat te ushtroje te drejtat dhe te permbushe detyrimet sipas kesaj Kontrate;
- (xiii) Ka ndermarre te gjitha veprimet e duhura dhe gezon te gjitha tagrat dhe kompetencat per te negociuar, lidhur, ekzekutuar dhe perfunduar kete Kontrate dhe se kjo e fundit eshte detyruese, e vlefshme dhe angazhuese kundrejt tij;
- (xiii) Autoriteti Portual Durres, ne baze te nenit 35.4 te ligjit nr. 9310/2003 “Per autoritetin portual” ka te drejten qe ne cdo kohe nepermjet marreveshjes me shkrim me

Koncesionarin, te ndryshoje pjeserisht ose teresisisht tarifat e publikuara e perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Daten Efektive. Pavaresisht nga sa me lart Koncesionari do te kete te drejten te kerkoje rishikimin e tarifave ne menyre qe struktura e tarifave te mos ndikojte negativisht ne aftesine e Koncesionarit per operimin eficient dhe kompetitiv te TKD.

- (xiv) Nuk ekziston asnjë akt, dokument dhe/ose veprim, i përfunduar, në proces e sipër dhe/ose pezull, para çdo gjykate, gjykate arbitrazhi, organi administrativ apo penal, etj, si dhe nuk ka qënë subjekt i ndonjë gjobe, penaltiteti, ndëshkimi, përgjegjësie civile apo penale që kanë ose mund të kenë një efekt i cili mund të ndikojë negativisht në përbushjen e detyrimeve sipas kësaj Kontrate;
- (xv) Nuk është paguar nga ai apo për llogari të tij asnjë shumë në para apo çfarëdo lloj interesi ndaj çdo funksionari, punonjësi apo përfaqësuesi të Autoritetit Kontraktues për të influencuar ose për t'u përpjekur të influencojë tek ata për lidhjen apo për të përfituar avantazhe në lidhje me këtë Kontratë;
- (xvi) Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Konçensionit do të ruajë kontrollin lidhur me menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen në Shoqërinë Konçesionare.
- (xvii) Në rast së dëshiron të transferojë kontrollin e shoqërisë do t'i kërkojë miratimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.
- (xviii) Autoriteti Portual Durrës ka të drejtë, në çdo kohë, të ndryshojë pjesërisht ose tërësisht, tarifat e publikuara në përputhje me legjislacionin mbi të cilin mbështetet veprimtaria e Autoritetit Portual Durrës.
- (xix) do të sigurojë që Autoriteti Kontraktues të mos mbajë përgjegjësi për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin gjatë ekzekutimit të Kontratës të kontraktuara nga vetë Koncesionari.
- (xx) ne rast se ngrihet ndonje pretendim ose padi kunder Autoritetit Kontraktues ne lidhje me ndonje shkelje te pronesise intelektuale gjate zbatimit te Kontrates ose nga perdorimi i sendeve te furnizuara sipas Kontrates, ai do t'i jape Autoritetit Kontraktues te gjitha provat dhe informacionin ne posedim te Shoqerise Koncesionare qe kane te bejne me kete padi apo pretendim.
- (xxi) në zbatim të Kushteve Standarde të këtij konçesioni dhe VKM-së nr. 546, datë 28.05.2009 "Per miratimin e masterplanit për zhvillimin e Portit të Durrësit" me qëllim zbatimin e këtij konçesioni dhe masterplanit në fjalë, do të lirojë (*nëpërmjet një marrëveshje të lidhur për këtë qëllim*) në favor të shtetit, përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, brenda 10 ditëve nga Data Efektive, truallin që *de facto* posedon brenda territorit të Portit të Durrësit dhe heq dorë në mënyrë të përvokueshme nga çdo pretendim për posedim mbi këtë truall, kjo në mbështetje edhe të kontratës për shitjen e kuotave shtet nr. 3752 rep., nr. 1085 kol., datë 12.08.2009 të noteres Drita Pepi dhe akteve për krijimin e shoqërisë së përbashkët shtet-privat Kantieri Detar Durrës-Gdansk Sh.A. (më pas ndryshuar emrin në Durrës Kurum Shipping Sh.A.).
- (xxii) brenda 6 (gjashtë) muajve do të marrë të gjitha masat dhe do të heq me shpenzimet e tij Dokun që gjendet ne Kantierin Detar. Në rast se Koncesionari dështon të përbush këtë detyrim, APD do të heq Dokun në vend të tij, por koncesionari duhet të rimbursojë menjëherë APD për shpenzimet. Në rast vonesash Autoriteti Koncesionar ka të drejtë ti mbaj këtë shumë nga garancia e kontratës.

2.5.2 Autoriteti Kontraktues dhe Autoriteti Portual Durres deklaron dhe garanton se:

- (i) Ne perputhje me Kushtetuten e Shqiperise ne rast ndarje, bashkim ose ndryshim portofolësh eventuale sipas ligjeve ne fuqi, shprehja "Autoritet Kontraktues", sipas kesaj Kontrate do t'i referohet ministrit pergjegjes te ngarkuar per drejtimin e politikave te transportit ne Republiken e Shqiperise.
- (ii) Te gjitha te dhenat dhe i gjithe informacioni i vene ne dispozicion jane te sakta, te verteta dhe pa gabime.
- (iii) Gezon te gjitha tagrat ne baze te Ligjit per te lidhur e nenshkruar kete Kontrate dhe nuk ka fshehur qellimisht asnje dokument apo informacion nga Koncesionari dhe eshte i vetedijshem se Oferta e Koncesionarit eshte pergatitur dhe dhe paraqitur duke u mbeshtetur ne keto informacione dhe/ose dokumenta;
- (iv) Zoteron gjithe tagrat e nevojshme e te kerkuara nga legjislacioni shqiptar, per nenshkrimin e kesaj Kontrate te cilat jane dhe do te jene ne force gjate gjithe vlefshmerise te kesaj Kontrate, dhe se kjo Kontrate eshte nje detyrim i ligjshem dhe i zbatueshem per Autoritetin Kontraktues dhe APD si dhe per cdo person te cilit i kalohen apo trashegon kete detyrim.
- (v) Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate nga Autoriteti Kontraktues dhe APD nuk perben dhe nuk do te perbeje shkelje apo kundervajtje me percaktimet e ligjit shqiptar dhe/ose me kontrata dhe/ose marreveshje ne te cilat Autoriteti Kontraktues dhe APD jane pale.
- (iv) Asnje urdher, urdher ekzekutimi, urdher kufizues me karakter administrativ, rregull/rregullore, vendim, pezullim ose sekuestrim nuk do te zbatohet ose urdherohet te zbatohet nga ndonje organ administrativ ose Ent Shteteror qe ka juridiksion mbi çeshtjen qe kufizon, ndalon ose deklaron te paligjshme aktivitetet e kryera ne perputhje me kete Kontrate.
- (v) Ne çdo rast do t'i njohe Konçensionarit te Drejten e Kalimit;
- (vi) Do te beje te gjitha perpjekjet per te asistuar dhe ndihmuar Konçesionarin dhe/ose Shoqërinë Konçesionare gjate procedurave per pajisje me Leje, Autorizime, Liçensa;
- (vii) Transferimi i aksioneve/pjesëve në rastet kur humbet kontrolli i Konçesionarit lidhur me menaxhimin, mbikëqyrjen dhe vendimmarrjen në Shoqërinë Konçesionare në referim të nenit 2.4.1/(xvi) do të kryhet vetëm në rast se Autoriteti Kontraktues ka dhënë miratimin paraprak;
- (viii) Koncesionari eshte i lire t'u ofroje klienteve t vet rimbursime ose ulje te normave tarifore te publikuara nga APD, por ne çdo rast do te respektoje legjislacionin ne fuqi per konkurrencen dhe veçanerisht nuk do te ofroje asnje sherbim me çmim me te ulet se kostoja.
- (xix) Infrastruktura dhe superstruktura ekzistuese duke perfshire dhe kalatat eshte ne perputhje me standartet inxhinierike dhe te sigurise se Praktikes se Industrise se Mire Europiane dhe se kalatat jane te qendrushme dhe pa rreziqe strukutrore me një kapacitet 4 t/m2 për kalatat dhe 6 t/m2 për sheshet.

Neni 3

Angazhime te Paleve

3.1 Palet ne kete Kontrate marrin persiper dhe bien dakord si me poshte:

3.1.1 Konçesionari merr persiper dhe bie dakord:

- (i) Te lirojë truallin që e mbante në posedim, brenda Portit të Durrësit brenda 10 ditëve nga Data Efektive, , ne kushtet aktuale sipas parimit "sic eshte, ku eshte"; .
- (ii) t'i jape Autoritetit Kontraktues kopje origjinale (ose te vertetuara nga noteri) te policave se sigurimit qe kerkohen nga kjo Kontrate brenda 30 (tridhjete) diteve nga lindja e detyrimit per t'u pajisur me keto polica;
- (iii) t'i jape Autoritetit Kontraktues kopje origjinale (ose te vertetuara nga noteri) te dokumentacionit te krijimit dhe regjistrimit te Shoqerise Konçesionare si dhe te ekstrakteve perkatese brenda 30 (tridhjete) diteve nga Data Efektive;
- (iv) t'i jape Autoritetit Kontraktues kopje origjinale (ose te vertetuar nga noteri) te kontrates qe do te lidhet mes Konçesionarit dhe Shoqerise Konçesionare per cedimin/kalimin e ketij Konçesioni;
- (v) t'i dorezoje Autoritetit Kontraktues, jo me vonë se 150 dite nga Data Efektive, nje liste me pajisjet dhe mjetet te deklaruar ne Oferten e Konçesionarit;
- (vi) i'i paraqese per miratim Autoritetit Kontraktues, brenda 6 (gjashte) muajsh nga Data Efektive, dokumentat siç citohen ketu ne vijim dhe pershkruhen me me hollesi ne Dokumentat Standarde: —
 - a. Rregulloret e Detajuara te Sigurise Teknike dhe Shendetesore,
 - b. Planin e Sigurise per Facilitetin e Portit,
 - c. Planin Operacional,
 - d. Planin e organizmit te Burimeve Njerezore,
 - e. Listen e Mjeteve dhe Pajisjeve,
 - f. Listen e Puneve per modernizimin dhe permiresimin teknik te terminalit,
 - g. Preventivin e Mirembajtjes dhe Riparimeve,
 - h. Planin e Biznesit,
 - i. Parashikimin e Trafikut,
 - j. Planin e Marketingut (per 5 vitet e para),
 - k. Listen dhe Pershkrimin e Rrjetit Kompjuterik dhe softëare,
 - l. Planin e zyrave, vendeve te Punes, Pajisjeve dhe Parkimeve te Makinave, shenjave te Trafikut, etj.,
 - m. Planin per Pajisjet e Sigurise,
 - n. Planin e mbrojtjes nga zjarri,
 - o. Progamin e Menaxhimit te Mbetjeve,
 - p. Konceptin e detajuar per higjenen dhe pastertine,
 - q. Programin e Shenimit dhe Lyerjes bashke me grafikun perkates bashkengjitur atij,
 - r. Formularet e Detajuar te Statistikave, Regjistrimit dhe Raportimit dhe
 - s. Planin per menaxhimin, perdorimin, transferimin, izolimin e mallrave te klasifikuar te rrezikshem.
- (vii) T'i jape Autoritetit Kontraktues, brenda 12 (dymbedhete) muajve, dokumente qe tregoje se Konçesionari disponon te gjithë burimet e nevojshme financiare me burime nga te tretet

3.1.2 Autoriteti Kontraktues merr persiper dhe bie dakord:

- (i) Do t'i sigurojë Konçesionarit Lejet, Autorizimet, Liçensat e kerkuara per Projektin, që janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues apo APD, me kusht qe Konçesionari te kete plotesuar dhe paraqitur te gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor per leshimin e tyre;

- (ii) Do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të asistuar Konçesionarin lidhur me Lejet, Autorizimet, Liçensat e kerkuara per Projektin, që nuk janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues apo APD me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për leshimin e tyre;

Neni 4

Sigurimi i Kontrates

4.1 Konçesionari, me qëllim përmbushjen e detyrimeve gjatë ekzekutimit të Kontrates, do t'i ofroje Autoritetit Kontraktues një Sigurim Kontrate të përvokueshem dhe të pagueshem me kërkesen e pare, në formën e një police sigurimi të pakushtëzuar të leshuar nga shoqëri sigurimi shqiptare ose në formën e një garancie bankare të përvokueshme dhe të pagueshme me kërkesen e pare, të leshuar nga një bankë e nivelit të dytë e licencuar në Republikën e Shqipërisë në shumën 3,250,000. USD që i korrespondon 10 (dhjete) % të Vlerës së Investimit.

4.2 Konçesionari do të jetë përgjegjës për plotësimin e shumës së Sigurimit të Kontrates sa herë që kjo shumë preket sipas kësaj Kontrate për kryerje pagesash në favor të Autoritetit Kontraktues. Ky plotësim do të kryhet brenda 3 (tre) javësh nga data e dorëzimit tek Konçesionari i një njoftimi me shkrim në lidhje me një prëkje të plote ose të pjeshme të Sigurimit të Kontrates. Në rast mosplotësimi në afat, Autoriteti Kontraktor ka të drejtën e një demshperblimi të barabartë me shumën e sigurimit të Kontrates.

4.3 Garancia e Kontrates duhet të jetë në fuqi deri në 90 ditë pas datës së përfundimit të Kontratës.

Neni 5

Pronesia Intelektuale

5.1 Autoriteti Kontraktues dhe APD garantojnë Konçesionarin se kanë të gjitha të drejtat e pronësive intelektuale (nese është rasti) përfshirë liçensat e duhura që kanë të bëjnë me *hardware-t* dhe programet kompjuterike (*softwares*) që do të përdoren gjatë zbatimit të kësaj Konçesioni, deri në Datën Efektive.

5.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Konçesionari gjatë Kontrates, përveç atyre që i përkasin ekskluzivisht Konçesionarit, do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

5.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Konçesionari, pas përfundimit të kontrates, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhenat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë Kontrates. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhenave, por nuk duhet t'i përdorë për qëllime që nuk kanë lidhje me Kontraten, përveçse kur pajiset me leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues..

Neni 6

Njesia e Zbatimit të Projektit (NjZP)

Brenda 1 (një) muaji nga Data Efektive, me Urdher të Ministrit të MPPT krijohet Njesia e Zbatimit të

Projektit Konçesionar ("NjZP") prane MPPT. Perberja dhe pergjegjesite e NjZP do te percaktohen ne Urdhrin e Ministrit. Ky Urdher nuk do te permbaje detyrime kontraktore shitesë ndaj Konçesionarit ndaj NjZP. Puna e NjZP do te vazhdoje gjate gjithe Periudhes Konçesionare.

Neni 7

Data Efektive e Kontrates

- 7.1 Data Efektive e kesaj Kontrate do te jete data e hyrjes ne fuqi te vendimit te Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise me te cilin do te miratohet kjo Kontrate.

Neni 8

Çeshtje Financiare

8.1 Tarifa e Konçensionit

- 8.1.1 Konçesionari detyrohet t'i paguaje Autoritetit Kontraktues nje Tarife Konçesioni te barabarte me 2 (dy) % te Xhiros Vjetore (para tatim fitimit dhe duke perjashtuar TVSH-ne) qe Konçesionari do te grumbulloje nga mbledhja e tarifave gjatë operimit të TKD, bazuar ne deklarimet financiare te kontrolluara te Shoqerise Koncesionare per çdo Vit Financiar.
- 8.1.2 Detyrimi i Konçesionarit per pagesen e Tarifes se Konçensionit, fillon nga Data e fillimit te operimit dhe do te paguhet çdo muaj brenda dates 15 (pesembëdhjetë) muajit pasardhes per muajin paraardhes. Gjithsesi ne rast se Konçesionari fillon te vjele tarifa para kesaj date ai detyrohet te paguaje Tarifen e Konçesionit qe nga momenti kur ka filluar t'i vjele ato.
- 8.1.3 Pas nje periudhe nje javore gratis (grace period) nga data e percaktuar per pagesen, cdo pagese e pakryer (e prapambetur) e tarifave te Konçensionit qe rrjedhin nga kjo Kontrate do te paguhet se bashku me nje interes prej 0.03% per cdo dite pune vonese, e llogaritur kjo mbi tarifen e papaguar (e prapambetura). Ne rast se Konçesionari do te jete ne vonese mbi 3 (tre) muaj apo tarifat e papaguara se bashku me interesat perkates sipas ketij neni kapercejne 10 % (dhjete) te shumes se sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktues do te kete te drejte ta zgjidhe kontraten dhe te mbajë pagesat per tarifat e prapambetura plus interesat perkates nga shuma e Sigurimit te Kontrates.

8.2 Pagese per konçesionin (Royalty)

- 8.2.1 Konçesionari detyrohet t'i paguaje Autoritetit Kontraktues nje Pagese Konçesioni (royalty) te barabarte me 21% (njezetenje perqind) (pasi të jetë zbritur TVSH dhe Tatim Fitimi (nese aplikohen), por pa zbritur shpenzimet apo kostot e çdo lloji) për të gjitha tarifat e punëve të përpunimit të kontejnerëve përfshirë ngarkim shkarkimin dhe shërbimet e siguruar në bazë të tarifave të publikuara të APD të pagueshme çdo muaj për muajin paraardhës
- 8.2.2 Data e fillimit te perllogaritjes te Pageses se Koncesionit do te jete dita kur Koncesionari do te filloje efektivisht te kryeje sherbimet dhe te vjele tarifat per kryerjen e tyre. (Data e Fillimit të Operimit).
- 8.2.3 Pagesat e Konçesionit te papaguara (te prapambetura) ne daten e percaktuar ne kete

Kontrate do te paguhen pas kesaj date se bashku me nje interes prej 0.03 % per çdo dite vonese llogaritur mbi tarifat e papaguara (e prapambetura). Ne rast se Konçesionari do te jete ne vonese mbi 3 (tre) muaj per te pakten nje pagese apo tarifat e papaguara se bashku me interesat perkates sipas ketij neni kapercejne 10 % (dhjete) te shumes se sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktues do te kete te drejte ta zgjidhe kontraten dhe te mbajë pagesat për Tarifat e prapambetura plus interesat perkates nga shuma e Sigurimit te Kontrates.

- 8.2.4 Me mbylljen e Vitit Financiar dhe çertifikimin e bilancit Palet do te kryejne rakordimet lidhur me Pagesen Konçesionare sipas nenit 8.1 dhe Pageses per Koncesionin (royalty) neni 8.2. Mosmarrëveshjet lidhur me rakordimet deri ne vleren 20.000 000 leke nuk do të përbëjnë shkak për mos kryerjen e pagesave pasardhëse.

8.3 Tarifat e Sherbimit

- 8.3.1 Shoqeria Konçesionare do te aplikojë Tarifat e Sherbimit siç percaktohet ne Aneksin IV bashkengjitur kesaj Kontrate duke filluar nga Data e Operimit.

- 8.3.2 Tarifat e Sherbimit do te indeksohen, çdo 5 (pese) vjet bazuar ne Normen e Inflacionit, sipas formules ne vijim:

$$IR = (NI^{(2)} - NI^{(1)})/NI^{(1)}$$

- "IR" do te thote Indeksi i Rishikimit te Tarifave te Kontrollit;

- "NI⁽¹⁾" do te thote Norma e Inflacionit ne vitin e 3-te (trete) pararendes te vitit ne te cilin do te kryhet rishikimi i Tarifave te Kontrollit; dhe

- "NI⁽²⁾" do te thote Norma e Inflacionit ne vitin ne te cilin do te kryhet rishikimi i Tarifave te Kontrollit.

Do te merret per baze Norma e Inflacionit e deklaruar ne baza 3 mujore, ose 6 mujore, ose 9 mujore, ose 12 mujore ne varesi te Dates Efektive.

- 8.3.3 Konçesionari ka te drejte t'i kerkoje Autoritetit Kontraktues bisedime ne lidhje me ndryshimin e tarifave te sherbimit.

8.4 Vlera e Investimit

Vlera qe Konçesionari do te investoje ne kete Konçesion është 32.500.000 USD (tridhjetë e dy milionë e pesëqind mijë dollarë amerikanë).

8.5 Rishikimi i kostove dhe shpenzimeve

Ne rast se secila nga Palet do te kerkoje rishikim te kostove dhe shpenzimeve te Konçesionit, duhet te njoftoje Palen tjeter me shkrim, duke respektuar Proceduren e Ndryshimeve te Kontrates, sipas kesaj Kontrate brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga marrja dijeni per nje rritje te tille. Palet brenda 5 (pese) diteve pas njoftimit do te takohen dhe do te diskutojne mbi rishikimin e kostove dhe shpenzimeve dhe reflektimin qe kane mbi Tarifat e Sherbimit.

Duke qene se eficenca dhe xhiros se planifikuar ne terminal, mbi te cilen bazohet dhe Tarifa Koncesionare dhe Pagesa e Koncesionit, do te ndikohet thelbesisht nga faktore ekonomike te brendshem dhe te jashtem dhe nga fenomene rajonale, keto do te jene objekt rishikimi bazuar ne kushtet ekzistuese dhe zhvillimin e ketyre kushteve pertej kontrollit te Koncesionarit.

Me qellim shmangien e çdo paqartësie paragafi me siper i ketij neni nuk do te interpretohet sikur lind ndonje detyrim per Autoritetin Kontraktues qe te pranoje ndryshimet e kontrates per qellimet e mesiperme.

8.6 Financimi i Konçesionit

Financimi i Konçensionit do te kryhet nga Konçesionari sipas Ofertes se Koncesionarit me burimet e veta dhe/ose me burime te siguruara menyre te ndryshme financimi ose nga Institucione Financiare.

8.7 Pagesat

Me perjashtim kur eshte rene dakord ndryshe me Paleve, Konçesionari do t'i paguaje Autoritetit Kontraktor ose sipas rastit APD-se, pa njoftim te metejshem, sipas përcaktimit në Dokumentat Standarde ne datat e rena dakord sipas menyres se pageses te rane dakord mes paleve. Per çdo pagese, Konçesionari duhet te paraqese origjinalin dhe kopjen elektronike te dokumentit te pageses shoqeruar nga dokumentacioni qe pershkruan sherbimet e kryera per te cilat kryeht pagesa.

Date e pageses do te jete data e depozitimit te shumes se pageses ne banke. Koncesionari do ti dorezoje Autoritetit Kontraktues kopjen e SWIFT-it te pageses nepermjet te cilit eshte kryer kjo pagese. Koncesionari nuk do te jete pergjegjes per vonesat e shkaktuara nga Banka.

Pagesa duhet te kryhet ne monedhen Shqiptare ose ne Euro, perveçse kur eshte rene dakord ndryshe, paraprakisht dhe me shkrim mes paleve. Nese do te linde nevoja per referim tek kursi i kembimit, si kurs kembimi i monedhave te ndryshme, do te jete kursi i Bankes se Shqiperise ne ditën e pageses.

Neni 9

Konçesionari dhe Shoqeria Konçesionare

- 9.1 Konçesionari me qellim zbatimin dhe permbushjen e kushteve te kesaj Kontrate eshte i detyruar, sipas afateve te percaktuara ne kete Kontrate, te themeloje nje Shoqeri Konçesionare ne perputhje me legjislacion shqiptar, te ciles duhet t'i transferoje te drejtat dhe detyrimet e kesaj Kontrate Konçesioni. Gjate gjithe Periudhes Konçesionare Konçesionari dhe Shoqeria Konçesionare do te jene debitore solidare ne zbatimin dhe permbushjen e kushteve te Kontrates se Konçesionit.
- 9.2 Shoqeria Konçesionare do te themelohet duke pasur si ortak te vetem Konçesionarin.
- 9.3 Objekti i aktivitetit te Shoqerise Konçesionare do te kufizohet ne zbatimin e kesaj Kontrate Konçesioni si dhe ne çdo aktivitet tjeter ndihmes ne funksion te zbatimit dhe permbushjes se kushteve te kesaj Kontrate Konçesioni.
- 9.4 Gjate Periudhes Konçesionare, ortakët/aksioneret e Shoqerise Konçesionaredhe/ose Shoqeria Konçesionare mund te transferoje pjeset/aksionet ne favor te ndonje pale te trete me miratimin paraprak me shkrim te Autoritetit Kontraktues.
- 9.5 Konçesionari, ka te drejte te vendosi barre siguruese (peng ose barre tjeter) mbi inventarin dhe te ardhurat e veprimtarise se tij (pervec Tarifes Koncesionare dhe Pageses se Koncesionit) gjate gjithe Periudhes se Konçesionit ne favor te paleve te treta, perfshire por pa u kufizuar ne institucione financiare. Krijimi i barres mbi Tarifes Koncesionare dhe Pageses se Koncesionit do te kryhet vetem me miratimin e Autoritetit Kontraktor.

Neni 10

Nenkontraktimi dhe transferimi i te drejtave

- 10.1 Konçesionari mund te nenkontraktoje nje ose disa prej detyrimeve te tij sipas kesaj Kontrate,

por gjithësi jo me shume se 20 % te tyre ne total, pas lidhjes se nje kontrate te shkruar per kete qellim dhe pas miratimit paraprak te Autoritetit Kontraktues, miratim i cili do te jepet brenda 10 (dhjete) diteve nga dita e venies ne dijeni nga Konçesionari. Ky miratim nuk do te refuzohet apo vonohet pa shkaqe te arsyeshme. Ne rast se, Autoriteti Kontraktues nuk kthen pergjigje brenda afatit te sipershenuar, nenkontraktimi do te konsiderohet i miratuar. Per menjanimin e ndonje keqkuptimi furnizuesit e pajisjeve, materialevedhe/ose dergesave nuk do te konsiderohen nenkontraktore sipas kesaj Kontrate.

- 10.2** Pavaresisht nga nenkontraktimet e detyrimeve nenkontraktoreve, Konçesionari do te jete i vetem pergjegjes perpara Autoritetit Kontraktues per permbushjen e kesaj kontrate dhe Konçesionari do te garantoje Autoritetin Kontraktues ndaj çdo pretendim apo kerkese e paraqitur nga çdo nenkontraktor.
- 10.2** Konçesionari do te njoftoje Autoritetin per Nen-Kontraktoret me informacionin e meposhtem:
- (i) Emrin, eksperiencen dhe adresen;
 - (ii) Qellimet per te cilat nen-kontraktuesi i propozuar do te kontraktohet, duke perfshire çdo sherbim qe do te ofrohet nga nen-kontraktuesi i propozuar;
- 10.3** Per qellime te nenkontraktimit, Konçesionari mund te angazhoje çdo person qe posedon aftesite e nevojshme, njohurite speciale dhe aftesite per ndertim, inxhinieri, prokurim dhe ndertim civil/mekanik, inxhinieri elektrike, apo te çdo fushe tjeter qe ka lidhje me Projektin apo me menaxhimin, shfrytezimin optimal dhe mirembajtjen e Infrastruktures dhe Sherbimeve te Projektit. Gjithësi: Konçesionari do te jete i vetmi pergjegjes para Autoritetit Kontraktues per te gjitha demet, mospermbushjet dhe veprimet a mosveprimet jo ne perputhje me kete Kontrate apo te mangeta te nen-kontraktoreve te tij, dhe çdo kontrate qe te jete e pranueshme per Projektin duhet te jete ne perputhje dokumentat dhe bazen tekniko-ligjore te projektit.
- 10.4** Konçesionari nuk lejohet në asnjë rast të nenkontrakttojë sherbimet thelbesore te Konçesionit. Nenkontraktimi per sigurine nen kuptimin e kodit ISPS do te kryhet vetem nqs aprovohet nga APD.
- 10.5** Kontraktuesi ndalohet te transferoje, teresisht ose pjesisht, detyrimet e tij sipas Kontrates me perjashtim te rastit kur Autoriteti Kontraktor miraton paraprakisht me shkrim nje transferim te tille.

Neni 11

Sigurimi

11.1 Kerkesat per sigurim

Konçesionari duhet te siguroje dhe mbaje te vlefshem nje sigurim te detyrueshem profesional ne perputhje me rregullat dhe praktikat e pergjithshme te pranuar qe permbajne detyrimet e ketij konçesioni ne menyre qe te zhedemtoje Autoritetin Kontraktues dhe APD nga demet, humbjet e shkaktuara ndaj personelit te Autoritetit Kontraktues dhe/ose APD ose te prones nga pakujdesia, deshtimet, gabimet ose ndonje mangesi tjeter gjate ushtrimit te veprimtarise, detyrimeve ose sherbimeve te Konçesionarit.

11.2 Mbulimi me Sigurim

Shuma minimale e mbulimit me sigurim do te jete jo me pak se 70 % e vlerës së investuar.

20

1

11.3 Prova e Mbulimit me Sigurim

Konçesionari duhet t'i vere ne dispozicion Autoritetit Kontraktues kopje te policave te sigurimit te cilat Konçesionari eshte i detyruar te zoteroje ne perputhje me kete Kontrate.

11.4 Vlefshmeria e Mbulimit te Siguracisionit

Konçesionari duhet te paguaje primet e sigurimit te policave te detyrueshme sipas kesaj Kontrate gjate gjithe Periudhes se Konçesionit dhe t'i vere ne dispozicion Autoritetit Kontraktues kopje te policave te sigurimit. Çdo police sigurimi duhet te parashikoje qe nuk perfundon ose anulohet me heret se 10 (dhjete) dite nga dita kur nje perfundim apo anullim i tille i eshte njoftuar Autoritetit Kontraktues me shkrim. Nese Konçesionari, gjate Periudhës së Konçesionit, deshton te paguaje primet e sigurimit te policave te sigurimit te percaktuara ne kete Kontrate, Autoriteti Kontraktues ka te drejte t'i paguaje vete te gjitha sigurimet per te pasur nje police sigurimi te vlefshme dhe këto shuma ka të drejtë t'i mbajë nga Sigurimi i Kontratës.

11.5 Bashkeperfituesi ne siguracione

Autoriteti Kontraktor do te figuroje gjithmone si bashkeperfitues i siguracioneve ne policat e sigurimit qe do te leshohen. Ne rast se Autoriteti Kontraktor nuk figuron si bashkeperfitues ne çdo police sigurimi te leshuar sipas ketij neni, Konçesionari do te konsiderohet se nuk ka permbushur detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate per te ofruar polica sigurimi te vlefshme ne perputhje me Kontraten.

11.6 Moskryerja apo mosrinovimi i siguracioneve

Konçesionari detyrohet te siguroje, te rinovojë apo te mbajë te vlefshem apo ne fuqi çdo siguracion sipas ketij neni gjate gjithe Periudhës së Konçesionit. Ne te kundert, Autoriteti Kontraktues ka te drejte kryesisht te pajiset me policat e sigurimit qe mungojne apo nuk jane te vlefshme apo ne fuqi ne nje moment te caktuar, duke mbajtur primin/primet perkatese per siguracionet ne fjale nga Sigurimi i Kontrates.

Neni 12

Shfrytezimi dhe Mirembajtja e Konçesionit

121 Detyrimet e Konçesionarit

12.1.1 Administrimi dhe shfrytëzimi

Krahas detyrimeve te tjera ne kete Kontrate, Konçesionari do te administroje dhe, shfrytëzoje, krejtesisht me shpenzimet, kostot dhe nen pergjegjesine e vet asetet e luajtshme dhe ta paluajtshme ne perputhje me parashikimet e kesaj Kontrate. Detyrimet e Konçesionarit do te perfshijne, por nuk do te kufizohen, ne te meposhtmet:

- a. Do te filloje menjehere veprimtarine e shfrytëzimit te Infrastruktures TKD duke filluar nga Data Efektive;
- b. Do te siguroje nje perdorim optimal te TKD;

- c. Do të sigurojë që Shërbimet të kryhen konform Standarteve të Shfrytëzimit dhe Mirembajtjes si dhe Standarteve të Sigurisë dhe që ekzistojnë kushte shfrytëzimi të sigurta, funksionale dhe normale e të përdorshme të rrjedhës së trafikut portual;
- d. Do të minimizojë rrjedhën e trafikut në rast aksidentesh apo incidentesh që prekin sigurinë dhe shfrytëzimin e Infrastruktura dhe Shërbimeve duke vepruar shpejt dhe gatshëm dhe duke mbajtur lidhje me shërbimet e urgjencës të Autoritetit Kontraktues apo të enteve të tjera;
- e. Do të ketë gati për përdorim të gjitha burimet financiare, teknike, teknologjike, administrative dhe burime të tjera për shfrytëzimin, mirembajtjen, riparimin dhe zëvendësimin e Infrastruktura dhe Shërbimeve sipas afatëve të përcaktuara në Kontratë;
- f. Përveç rasteve të urgjencës të shfrytëzojë dhe administrojë Infrastrukturen dhe Shërbimet, sipas parimit 'kush vjen i pari, shërbehet i pari' (*first come, first serve*) dhe atij të mosdiskriminimit.
- g. Do të sigurojë ruajtjen në mënyrën e duhur të të dhënave/ regjistrimeve/llogarive që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e TKD si dhe pasqyrimin e sakte të xhiros së kryer dhe të tarifave të vjela;
- h. Do të pajiset, mbaje të vlefshme dhe zbatojë Lejet, Autorizimet, Liçensat dhe do të zbatojë Ligjet, përfshirë, por pa u kufizuar, ato që kanë të bëjnë me sigurinë e pontilëve, platformave, ambienteve të brendshme (ujore dhe tokësore) të zonës së konçesionit, shëndetit, mjedisit dhe sigurinë në punë.
- i. Në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate do të kryejë, marrë përsipër apo sigurojë, në lidhje me Projektin, të gjitha shërbimet që Autoriteti Kontraktues do të ishte i autorizuar të kryente, merrte përsipër apo sigurojë sikur t'i kryente vetë këto shërbime.
- j. Nëse do të jete rasti do të parandalojë, duke kërkuar ndihmën e organeve ligjzbatuese, çdo cenim apo përdorim të paautorizuar të Infrastruktura dhe Shërbimeve të Projektit.

12.1.2 Riparimet dhe Mirembajtja

Konçesionari me shpenzimet e veta:

- a. do të riparojë dhe mirembaje TKD apo ndonjë pjesë të tyre dhe për këtë qëllim do të marrë masa ruajtje parandaluese dhe do të mirembaje TKD përfshirë shtrimin e rrugëve, riparimin e strukturave (por nuk do të zëvendësojë, rehabilitojë, përmirësojë, nëse këto struktura nuk janë në standartet e përcaktuara në këtë Kontratë) dhe riparimin e pajisjeve dhe furnizimin me to. Pavarësisht nga sa më lart Konçesionari nuk do të nderhyjë në infrastrukturen ekzistuese apo me mirembajtje që kërkon rehabilitim të thellë dhe/ose ristrukturim dhe/ose zëvendësim të strukturës tokësore dhe arsye të tjera që mund të përbejnë shkak për pengimin e funksionimit të terminalit. Këto punime do të kryhen në përgjegjësinë e Autoritetit Kontraktues ose agjenteve të tij me shpenzimet e tyre;
- b. do të mirembaje Infrastrukturen dhe Shërbimet e Projektit në përputhje me parashikimet e kësaj Kontrate dhe me Praktikat e Industrisë së Mire me objektivin për të ofruar standarte shërbimi të përshtatshme dhe për të siguruar që asetet e luajtshme dhe të paluajtshme që do të transferohen tek Autoriteti Kontraktues me

mbarimin e Periudhes se Konçesionit te jene ne gjendje te mire, perjashtuar amortizimin normal.

12.1.3 Zevendesimi i Pajisjeve

Konçesionari, me shpenzimet dhe kostot e tij do te planifikoje zevendesimin ne kohe te pajisjeve para se pajisja ne fjale ne menyre te arsyeshme pritet te priset dhe do ta zevendesoje pajisjen ne perputhje me Praktikate e Industrise se Mire ne menyre qe te siguroje qe Infrastruktura dhe Sherbimet e Projektit te jene ne perputhje me Kerkesat e Projektit gjate gjithe kohezgjatjes se Periudhes Konçesionare.

12.1.4 Riparimet, Zevendesimet apo restaurimet

Konçesionari me shpenzimet dhe kostot e tij, menjehere dhe me kujdes do te riparoje, zevendesoje apo restauroje TKD apo pjese te tij te cilat mund te kene humbur, te jene demtuar apo shkaterruar per faj te Konçesionarit, duke ruajtur cilesine dhe standartet percaktuar ne kete Kontrate.

12.1.5 Aksesi per inspektime

Konçesionari eshte i detyruar t'i ofroje te gjithe bashkepunimin eksperteve te caktuar nga Autoriteti Kontraktues per te verifikuar qe Projekti/Infrastruktura dhe Sherbimet e Projektit jane duke u shfrytezuar dhe mirembajtur ne perputhje me Standartet e Performances dhe qe po zbatohen Standartet e Shfrytezimit dhe Mirembajtjes si dhe Standartet e Sigurise. Verifikime te tilla do te kryhen çdo 6 (gjashte) muaj. Per me teper, menjehere me njoftimin paraprak nga Autoriteti Kontraktues, Konçesionari do t'iu ofroje perfaqesuesve te Autoritetit Kontraktues aksesin e nevojshem tek Asetet Portuale/Infrastruktura dhe Sherbimet e Projektit me qellim inspektimin dhe kontrollin prej tyre te veprimtarise dhe krijimit te bindjes prej tyre se kjo veprimtari po kryhet ne perputhje me Kontraten. Pavaresisht keti parashikimi me formulim te pergjithshem, eshte rene dakort qe Konçesionari veçanerisht do t'iu ofroje bashkepunim dhe informacion eksperteve te caktuar nga Autoriteti Kontraktues per te kryer nje kontroll lidhur me sigurine dhe per te verifikuar se Projekti/Infrastruktura dhe Sherbimet e Projektit jane ne perputhje ne menyre strikte me Standartet e Sigurise.

12.1.6 Raportimi

Konçesionari do t'i paraqese Autoritetit Kontraktues raporte mujore lidhur me trafikun e mjeteve lundruese dhe tarifate e vjela.

12.1.7 Sistemi dhe Rrjeti Kompjuterik

Konçesionari do te instaloje, perdore, mirembaje sistemin dhe rrjetin kompjuterik (perfshire Sistemin e Shkembimit te Dhenave dhe Sistemin e Komunikimit me Kapitenerine) duke ndjekur te gjitha protokollet qe Autoriteti Kontraktues do te percaktoje kohe pas kohe. Autoriteti Kontraktues nuk do te nderhyje ne implementimin dhe mirembajtjen e rrjetit kompjuterik ose sistemeve te ngjashme pervec rasteve kur kjo kerkohet nga Ligji.

12.1.8 Çeshtjet e Sigurise

Konçesionari veçanerisht lidhur me çeshtjet e sigurise do te zbatoje kerkesat e ligjit nr. 9281, date 23.9.2004 "Per sigurine ne anije dhe ne porte" dhe akte te tjera nen ligjore ne zbatim te ketij ligji me kusht qe keto akte te mos jene ne kundërshtim me ISPS-ne;

12.1.9 Punesimi i Personelit

Konçesionari do të punesoje personel të kualifikuar dhe të aftë për të përdorur Infrastrukturen dhe Shërbimet e Projektit. Kushtet e punësimit mund të përcaktohet sipas nevojave të tij nga Konçesionari, por do të jenë në përputhje me Ligjet dhe Konçesionari të mbajë çdo përgjegjësi në këto drejtim. Pa prekur formulimin e përgjithshëm të këtij parashikimi, i gjithë dokumentacioni që kërkohej lidhur me punësimin e personelit të huaj do të plotësohet dhe merret para punësimit apo kontraktimit të këtij personeli. Deshtimi për marrje të kësaj dokumentacioni nuk do të përbejë Force Majeure. Të gjithë të punësuarit janë përgjegjësi e Konçesionarit.

12.1.10 Punësimi i punonjësve aktualisht në marrëdhënie pune me APD-në

Konçesionari do të punesoje, nëpërmjet procedurës së transferimit të ndërmarrjes të parashikuar nga Kodi i Punës, punonjësit ekzistues të Autoritetit Portual (sipas listës bashkëngjitur kësaj Kontrate si Aneksi V për të paktën 2 vite në vazhdim dhe do të mbulojë çdo shpenzim apo pretendim të tyre sipas kontratave përkatëse kolektive dhe individuale të punës.

14.1.11 Konçesionari do të jetë përgjegjës i vetëm ndaj të gjitha detyrimeve që mund t'u shkaktohen të tjerëve si rezultat i veprimeve të tij gjatë ushtrimit të veprimtarisë së shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes sipas kësaj Kontrate, përveç përgjegjësisë që rrjedh nga struktura ndërtimore e dorëzuar jo në përputhje me dokumentacionin teknik të APD dhe për të cilat Konçesionari ka paraqitur rezervat e tij sipas nenit 14.1.2/a më sipër.

12.2 Të drejtat e Konçesionarit

(i) Ankorimi preferencial dhe prioritar

Konçesionari mund t'u ofrojë ankorim preferencial dhe prioritar një a me shumë linjave detare apo pronareve/operatorëve të anijeve për të maksimizuar përdorimin e Infrastruktures dhe Shërbimeve të Projektit. Ky ankorim preferencial dhe prioritar do të jetë subjekt i normave të ankorimit prioritar siç mund të bëhet dakort nga Palet në përputhje me Ligjet apo udhëzimet e nxjerra nga Autoritetet Shtetërore here pas here për këto qëllime.

(ii) Ngarkim-shkarkimi

Konçesionari sipas kësaj kontrate është i autorizuar të ofrojë shërbime ngarkim – shkarkimi vetëm për konteinere.

12.3 Shërbimet

Autoriteti Kontraktues do ta asistojë Konçesionarin që gjatë gjithë kohëzgjatjes së Periudhës së Konçesionit t'i sigurohet nga entet përkatëse akses në infrastrukture dhe shërbime përfshirë por pa u limituar në ujë, energji dhe telekomunikimin e nevojshme për zbatimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Projektit/Infrastruktures dhe Shërbimeve të Projektit në përputhje me Kontraten. Përveçse kur është rene dakort ndryshe:

- (a) energjia do të merret në pike-lidhjen të miratuar nga organi kompetent me shpenzimet e Konçesionarit;
- (b) furnizimi me ujë do të merret në pike-lidhjen të miratuar nga organi kompetent me shpenzimet e Konçesionarit;
- (c) Konçesionari me shpenzimet e veta do të instalojë pajisje matëse për të matur konsumin e ujit dhe energjisë. Autoriteti Kontraktues nuk garanton cilësinë dhe sasinë e ujit dhe të energjisë dhe nuk merr përsipër mosfurnizimin apo furnizimin e mangët me këto shërbime;

- (d) Koncesionari pranon rrjetin e furnizimi me energji dhe uje ne TKD te instaluar nga APD, si dhe pranon cdo kosto shtese qe lidhet me mirembajtjen dhe ndryshimet teknologjike ne lidhje me funksionimin e tij ne te ardhmen .

Neni 13

Te drejta, detyra dhe detyrime te pergjithshme

13.1 Te Koncesionarit

13.1.1 Lejet e aplikueshme

Koncesionari, gjate kohezgjatjes se Periudhes se Koncesionit, duhet te zbatoje dhe te jete ne perputhje me Lejet, Autorizimet, Licensat per kryerjen e shërbimeve të parashikuara në këtë Kontratë.

13.1.2 Taksat dhe detyrimet fiskale

Koncesionari, gjate Periudhes se Koncesionit, duhet te paguaje ne menyre te rregullt te gjitha Tarifen Koncesionare, Pagesen Koncesionare (royalty), taksat, tatimet, detyrimet, T.V.SH-ne, sigurimet shoqerore dhe shendetesore te te punesuarve, borxhet apo tatimin mbi te ardhurat, detyrimet per taksat indirekte, detyrimet doganore, taksat e shërbimeve te cilat mund te vilen, te merren ose te perfitohen ne cdo kohe sipas Ligjit nga cdo Ent apo Organ Shteteror duke perfshire ato, asetet e luajtshme dhe të paluajtshme dhe Shërbimet.

13.1.3 Detyrime shtese

Jashte vleres se Çmimit te Kontrates, Koncesionari gjate Periudhes se Shfrytezimit dhe Mirembajtjes do te perballoje te gjitha kostot dhe shpenzimet direkte perfshire takstat jo direkte, faturat dhe taksta e cdo lloji apo natyre te lidhura me fuqine punetore te punesuar nga Shoqeria Koncesionare nëpërmjet transferimit të punonjësve nga APD tek Kpnkesionari/Shoqëria Koncesionare.

Gjithashtu Shoqeria Koncesionare do te kete detyrimin per te menaxhuar, operuar, mekanizuar, mirembajtur dhe permiresuar teknikisht, perfshire mirembajtjen e fasiliteteve dhe makinerive, sheshet dhe zyrat oficinat dhe keto te perfshijne te gjitha kostot per rrogat, sigurimet shoqerore, energji elektrike dhe karburante per operacionet e mirembajtjes, materialet e konsumit, energji, uje, komunikime, largimin e mbeturinave, kompjuterizime, trajnime, sigurime, shendetin e personelit, kostot e sigurimit teknik dhe te mireqenies, kostot per sigurine.

13.1.4 Demshperblimi

Palet do te rregullojne gjithë pretendimet dhe kerkesat kundrejt njera tjetres, dhe do te rimbursojne ose ruajne nga demtimet Palen tjetër si dhe punonjesit e saj ne lidhje me humbje dhe/ose deme te shkaktuara dhe/ose kosto, tarifa/shpenzime te bera dhe/ose gjoba te vena dhe/ose ndonje ankese per shkak te lendimit ose vdekjes se cdo personi dhe/ose humbjes ose demtimit te shkaktuar ose te pesuar nga pronat ne pronesi ose qe i perkasin Pales tjetër te shkaktuara nga veprimet e Pales tjetër, dhe/ose punonjesit e saj, nepunesit apo agjentet, me kusht qe te jete marre nje vendim gjyqesor i formes se prere.

Koncesionari do te rimburohet menjehere ose do te mundesohet riparimi ne natyre, pas shkaktimit te nje demi direkt ose indirekt, cenim apo humbje, e cila vjen si pasoje e mosperputhjes me Praktiken e Industrise se Mire te infrastruktues se TKD.

13.1.5 Cedimi apo transferimi i te drejtave dhe kompetencave

Perveçse kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, Konçesionari nuk do te cedoje apo transferoje te drejtat, dhe detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate ne favor te ndonje personi pa pelqimin paraprak me shkrim te Autoritetit Kontraktues.

13.1.5 Te tjera

Konçesionari bie dakort qe, me shpenzimet e veta, te pakten 6 (gjashte) muaj para mbarimit te Periudhes se Konçesionit, nepermjet nje eksperti te pavarur te caktuar pelqimin e perbashket te Paleve, te kryeje nje analize te kushteve dhe nje inventar te gjithe Infrastruktures dhe Sherbimeve te Projektit. Nese, si rezultat i nje studimi dhe inventari te tille, eksperti i pavarur ka vene re se asetet e portit dhe/ose Infrastruktura dhe Sherbimet e Projektit ose ndonje pjese e tyre nuk jane mbajtur e shfrytezuar ne perputhje me kerkesat e kesaj Kontrate (perjashtuar amortizimin normal) Konçesionari duhet, me shpenzimet dhe kostot e veta, te ndermarre te gjitha hapat e nevojshme per t'i rikthyer ne te njejten gjendje te mire pune keto materiale apo prona para Dates se Transferimit.

13.2 Konfidencialiteti

Te gjitha te dhenat dhe dokumentet konfidenciale (financiare, teknike apo te çdo lloji tjetër) te dhena nga njera Pale, Pales tjetër, perveç kur eshte detyrim ligjor apo rezultat i nje kerkese apo urdhri nga organet kompetente shteterore, nuk duhet t'i behen te njohura te treteve, pa pelqimin opraprak me shkrim te Pales tjetër, me perjashtim te dhenies se informacioneve ne kushte domosdoshmerie keshilltareve ligjore/auditeve te pales se interesuar apo nenkontraktoreve te Konçesionarit ne masen e nevojshme per te permbushur nen-kontraten. Ky parashikim do te jete i vlefshem deri ne tre vjet pas perfundimit te Periudhes se Konçesionit.

13.3 Detyrimi per bashkepunim dhe respektim te te drejtave

Palet duhet te bashkepunojne me korrektesi, ne mirebesim dhe pa vonese me njera-tjetren ne menyre qe te arrihen objektivat e kesaj Kontrate.

Kjo kontrate dhe te drejtat, konçesionet dhe privilegjet e percaktuara ketu, perbejne te drejta te cilat i jane dhene Koncesionarit dhe Shoqerise Koncesionare dhe perveç kur palet bien dakord me marreveshje keto te drejta nuk mund te revokohen gjate Periudhes se Koncesionit.

Neni 14

Forca Madhore

14.1 "Force Madhore" do te thote çdo rrethane qe ne menyre te arsyeshme dhe objektive eshte tej parashikimit dhe kontrollit, te drejtperdrejte ose te terthorte, te pales se cenuar ("Pala e Cenuar") qe rezulton ose shkakton pamundesi te plote ose te pjesshme te Pales se Cenuar per te permbushur ndonje prej detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate (perveç kryerjes se pagesave te parave), por vetem nese dhe ne masen qe:

- i. kjo rrethane, pavaresisht ushtrimit te kujdesit te arsyeshem, nuk mund te parandalohet apo nuk ishte e mundur te parandalohet, shmangej ose menjanohej nga Pala e Cenuar;
- ii. Pala e Cenuar ka marre te gjitha masat e arsyeshme paraprake, kujdesin e duhur dhe masat e arsyeshme alternative ne menyre qe te shmangte pasojen e ketij rasti ne aftesine e Pales se Cenuar per te permbushur detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate dhe per te zbutur pasojat e saj;

- iii. ngjarja nuk është, ose nuk ka qene pasoje e drejtperdrejte ose e terthorte e shkeljes nga Pala e Cenuar te ndonje prej detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate, dhe
- iv. Pala e Cenuar t'i kete dhene njoftim Pales tjeter ("Pala e Pacenuar").

14.2 Rastet e Forces Madhore perfshijne rrethanat e meposhtme, por pa u kufizuar vetem ne to:

- i. veprimet e luftes, pushtimi ose akti i nje armiku te jashtem, ose aktet e terrorizmit, bllokadat, embargot, racionimet;
- ii. aktet e rebelimeve, kryengritjet, trazirat civile, grevat ne vendin e punes, grevat e pergjithshme ose lokale, grevat e natyres politike, aktet ose fushatat e terrorizimit;
- iii. rrufeja, zjarri, termeti, stuhia, cikloni, tajfuni, tornado ose ndonje fatkeqesi tjeter natyrore;
- iv. epidemite ose murtaja; dhe
- v. çdo akt sabotimi, drejtim i keq/krim i organizuar dhe/ose aktivite pune qe imponojne apo pengojne zbatimin e saj.

Pala e Cenuar do te perjashtohet nga permbushja e detyrimeve, dhe nuk do te quhet se është ne mospermbushje ne lidhje me Kontraten e Konçesionit per aq kohe, dhe ne ate mase, sa zgjat pamundesia objektive per te permbushur detyrimet si dhe Periudha e Konçesionit do te shtyhet automatikisht per aq sa do te zgjase Ngjarja e Forces Madhore.

14.3 Pasojat e Rasteve te Forces Madhore

Pavaresisht nga detyrimet per mirembajtje te Konçesionarit, ne masen qe Konçesionari është Pale e Cenuar ne nje Rast apo Ngjarje te Forces Madhore dhe pasojat e ketij Rasti apo Ngjarje te Forces Madhore jane brenda kushteve qe mbulohen nga garancite siguruese qe kerkohet te behet e te mbahet sipas Nenit 11 "Sigurimi", Konçesionari do te ngreje pretendime.

Neni 15

Rastet e Mospermbushjes

15.1 Rasti i Mospermbushjes nga Konçesionari apo Shoqëria Konçesionare

Secili prej rasteve te meposhtme do te perbeje nje "Rast Mospermbushjeje nga Konçesionari apo Shoqeria Konçesionare":

15.1.1 Konçesionari dështon të lirojë truallin e kanierit detar sipas pikës 2.5 (xxii).

Deshtimi per te paguar tek Autoriteti Kontraktues (perfshire ketu, per te menjanuar cdo dyshim, APD) brenda 3 muajsh pas afatit te fundit sipas Kontrates cdo lloj pagese apo kompensim tjeter qe tejkalon 20.000.000 (dhjetë milion) leke;

15.1.2 Konçesionari, me vendim gjykate të formës së prerë, dënohet për ndonjë Akt Korruptiv apo për se ka dhënë deklarime dhe ka paraqitur dokumenta të falsifikuara gjatë procedurës konkurruese dhe të përzgjedhjes si fitues i këtij Konçesionit;

15.1.3 finalizimi i paafetise paguese apo deklarimi i falimentimit;

- 15.1.4 Sigurimi i Kontrates eshte i pavlefshëm dhe nuk zevendesohet brenda 3 muajsh nga marrja e kerkeses per rinovim nga ana e Autoritetit Kontraktues;
- 15.1.5 Shoqeria Konçesionare shpreh qellimin per te revokuar/perfunduar kete kontrate pa pasur te drejten per ta bere nje gje te tille siç eshte parashikuar shprehimisht ne te;
- 15.1.6 Shoqeria Konçesionare qellimisht dhe me vetedije urdheron, udhezon, angazhon ose lejon me vetedije nje prej punonjesve, furnizuesve, nenkontraktoreve ose perfaqesuesve te ndermarrin veprime te cilat ndalohen ose perbejne shkelje te kesaj Kontrate dhe/ose Ligjit.
- 15.1.7 Çdo shkelje e kesaj Kontrate, qe per nga natyra dhe pasojat e saj eshte thelbesore, pavaresisht nese eshte percaktuar ose jo shprehimisht si e tille ne kete Kontrate;

15.2 Rasti i Mospermbushjes nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose APD

Secili prej rasteve te meposhtme do te perbeje nje "Rast Mospermbushjeje nga Autoriteti Kontraktues dhe/ose APD":

- 15.2.1 deshtimi per te permbushur detyrimet lidhur me Lejet, Licensat, Autorizimet me kusht qe Konçesionari te kete paraqitur te gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor;
- 15.2.2 Çdo shkelje e kesaj Kontrate, qe per nga natyra dhe pasojat e saj eshte thelbesore.

15.3 Te drejtat e Paleve ne Rast Mospermbushje

- 15.3.1 Pas shfaqjes se nje rasti mospermbushje sipas nenit 15.1 më sipër nga ana e Konçesionarit, dhe ne rast mosndreqeje te mospermbushjes sipas nenit 17.5, Autoriteti Kontraktues, ka te drejte te zgjidhe Kontraten.
- 15.3.2 Pas shfaqjes se mospermbushjes nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe/ose APD i cili nuk mund te ndreqet sipas nenit 15.5, Konçesionari ka te drejte te zgjidhe Kontraten.
- 15.3.3

Secila Pale, do te marre ne konsiderate natyren e shkakut te mospermbushjes dhe do te ndjekë procedurën për zgjidhje paqesore perpara se te procedoje me zgjidhjen e Kontrates sipas parashikimeve te nenit 18.4.

15.4 Njoftimet sipas Nenit 15

Secila prej Paleve duke ushtruar te drejten qe i jep neni 15.3, do t'i dergoje Pales tjeter nje njoftim paraprak me shkrim duke i shpjeguar me hollesi shkakun e mospermbushjes dhe do t'i propozoje bisedime mes Paleve per te gjetur nje zgjidhje miqesore.

15.5 Ndreqja e deshtimit per tu pajtuar.

Me te marre njoftimin sipas nenit 17 nga Pala tjeter, brenda nje afati jo me te gjate se 60 (gjashtedhete) dite periudhe bisedimesh/negocimesh ose per sa kohe palet do te bien dakord, Palet do te perpiqen te arrijne nje marreveshje me qellim te zgjidhin rastin e Mospajtimit.

15.6 Detyrimet gjate Periudhes se Ndreqjes

Me arritjen e nje marreveshje sipas parashikimeve te nenit 15.5 ketu me siper, Pala ne mospermbushje do te kryeje te gjitha veprimet e rena dakord per permbushjen e Kontrates brenda nje afati 60 (gjashtedhete) "Periudha e Ndrejjes".

Gjate Periudhes se Ndrejjes, Palet do te vazhdojne te permbushin detyrimet e tyre respektive sipas kesaj Kontrate.

15.7 Zgjidhja e Kontrates si pasoje e rastit te mospermbushjes

Nese gjate Periudhes se Ndrejjes, shkakun nuk eshte eliminuar ose zgjidhur, as nuk eshte arritur nje marreveshje ndermjet Paleve sipas ketij neni, Pala qe ka derguar njoftimin e ndrejjes ka te drejte te zgjidhe Kontraten. Ne kete rast parashikimet e nenit 16 "Zgjidhja e Kontrates si pasoje e rastit te mospermbushjes" do te zbatohen.

15.8 E drejta e Institucioneve Financiare per te nderhyre dhe per te zevendesuar Koncesionarin

E drejta e Institucioneve Financiare per te nderhyre dhe per te zevendesuar Koncesionarin

Dispozitat te cilat i japin institucionit financiar te drejten per te kerkuar nga Autoriteti Kontraktues "zevendesimin e koncesionarit me nje shoqeri tjetere" nese Koncesionari ndodhet para rastit te Mospermbushjes mund te perfshihet ne marreveshjet e financimit qe Koncesionari do te lidhe me Institucionet Financiare per te financuar tarifen e te drejtes koncesionare ose investimet qe do te kryeje Koncesionari ne TKD.

Autoriteti Kontraktues mund te miratoje transferimin e te Drejtes Koncesionare te TKD nga Institucionet Financiare tek nje shoqeri tjetere deri ne perfundim te afatit te mbetur te Kontrates vetem sipas afateve dhe kushteve te meposhtem dhe sipas te njejtave afate dhe kushteve dhe detyrimeve te parashikuara ne Kontrate:

- a. Institucionet Financiare duhet ti dergojne Autoritetit Kontraktues nje kopje me shkrim te marreveshjes se financimit maksimumi brenda 30 (tridhete) ditesh pas nenshkrimit te marreveshjes perkatese te financimit.
- b. Institucionet Financiare duhet te njoftojne Autoritetin Kontraktues (per te menjanuar cdo lloj dyshimi perfshire ketu Autoritetin Portual te Duresit APD) me shkrim dhe sebashku me dokumentacionin shoqerues se Koncesionari ndodhet perpara nje rasti mospermbushje sipas parashikimeve te marreveshjes se financimit dhe se e drejta e Institucioneve Financiare per te transferuar te Drejten Koncesionare ka lindur.

Pas ketij njoftimi, Autoriteti Kontraktues do te kerkoje qe Koncesionari te njoftoje Autoritetin Kontraktues brenda 15 (pesembedhete) ditesh lidhur me kundershtrimet dhe opinionet e tijnese rasti i Mospermbushjes ka ndodhur dhe gjithashtu nese e drejta e Institucioneve Financiare per te transferuar te Drejten Koncesionare ka lindur. Ne rast se Koncesionari nuk i pergjigjet ketij njoftimi, Autoritetit Kontraktues do te kryeje nje vleresim te vetin per te percaktuar nese e drejta e Institucioneve Financiare per te kerkuar transferimin e te Drejtes Koncesionare sipas marreveshjes se financimit dhe dokumenteve te tjera ekzistuese ka lindur.

Depozitimi i nje padie deklarative negative nfa ana e Koncesionarit kundrejt Institucioneve Financiare dhe fakti qe kjo kerkesepadi eshte ende ne kembe nuk do te pengoje , Autoritetin Kontraktues te kryeje nje vleresim dhe te marre nje vendim.

Koncesionari nuk ka te drejte te kerkoje ndonje kompensim nga apo te ngreje ndonje pretendim monetar kundrejt Autoritetit Kontraktues ose APD-së sipas nje vendimi gjykate ;

22

✓ |

cili percakton se Institucionet Financiare nuk kane te drejte te kerkojne transferimin e te drejtes koncesionare dhe/ose bazuar ne arsyetimin se Autoriteti Kontraktues ka kryer nje vleresim te gabuar.

- c. Autoriteti Kontraktues do te marre nje vendim nese ka perfunduar periudha 90 (nentedhjete) ditore e vleresimit duke filluar nga data ne te cilen Autoriteti Kontraktues ka marre njoftimin me shkrim ne te cilin deklarohet se e drejta per te kerkuar transferimin ka lindur,. Nese nje vendim gjykate eshte marre ne lidhje me situaten e Mospermbushjes dhe te drejten e transferimit gjate periudhes se vleresimit, Autoriteti Kontraktues do te kryeje vleresimet e tij ne perputhje me rezultatet e ketij vendimi gjykate.
- d. Ne rast se, si rezultat vleresimit qe do te kryhet, Autoriteti Kontraktues vendos se Koncesionari ndodhet perpara nje rasti mospermbushje dhe se e drejta e Institucioneve Financiare oer te kerkuar transferimin e te Drejtes Koncesionare ka lindur, Autoriteti Kontraktues do ti kerkoje Insitucioneve Financiare qe ta kryejne ate brenda 15 (pesembedhjete) ditesh, se bashku me te gjithë informacionin dhe dokumentet lidhur me shoqerine aksionare te ciles Autoriteti Kontraktues i kerkon qe ti transferohet e Drejta Koncesionare (dhe e cila ne perputhje me specifikimet e tenderit, do te percaktohet ekskluzivisht per funksionimin e TKD). Autoriteti Kontraktues do te kerkoje vecanerisht pajisjen me informacion dhe dokumente te cilat i perkasin struktures se aksionareve te kesaj shoqerie. Shoqeria te ciles Institucionet Financiare do ti kerkojne transferimin e te Drejtes Koncesionare, duhet te kete nga pikepamja e struktures se aksionareve, eksperience te mjaftueshme, njohuri, fuqi financiare dhe burime njerezore ne fushen e operacioneve portuale dhe duhet te permbushë kushtet e percaktuara ne nenin “Specifikimet e Tenderit” me titull ata qe mund te marrin pjese ne tender.
- e. Pas lidhjes së kontratës me shoqërinë e re koncesionare, kjo e funditdo te ftohet te paraqese letra garancie te cilat duhet te pergatiten ne perputhje me te njejtat afate dhe kushte te letrave ende te pakthyera te garancise te cilat jane mbajtur nga Autoriteti Kontraktues dhe Autoriteti Portual i Durrësit.
- f. Gjate periudhes 90 (nentedhjete) ditore te vleresimit te percaktuar ne Piken (iii) te ketij neni dhe kohes qe do te kaloje deri ne momentin e nenshkrimit te kontrates se re te koncesionit, Konçesionari është i detyrur të operojë TKD në përputhje me Praktikat e Industrisë së Mirë.
- g. Brenda 10 (dhjete) ditesh (perfshire ketu daten e nenshkrimit) pas nenshkrimit te kontrates se re te koncesionit, TKD do te transferohet dhe do ti dorezohet operatorit te tij te ri nepermjet dokumentit te transferimit dhe dorezimit i cili do te nenshkruhet nga Autoriteti Kontraktues, koncesionari dhe operatori i ri. Qellimi i detyrimit te dorezimit te Koncesionarit do te percaktohet ne perputhje me parashikimet e nenit 19 te Kontrates.
- h. Nese percaktohet se Koncesionari nuk ka detyrime te pashlyera dhe se detyrimi i dorezimit eshte permbushur rregullisht, letrat e garancise ende te pakthyera te cilat Koncesionari i ka paraqitur ne perfitim te Autoritetit Kontraktues dhe Autoritetit Portual te Durrësit lidhur me Kontraten do te kthehen jo me shume se 30 (tridhjete) dite pas dates se transferimit-dorezimit.
- i. Afati i Kontrates se re te Koncesionit do te kufizohet nga afati i mbetur i kesaj Kontrate.

15.9. Transferimi i kompetencave te Autoriteti Kontraktues dhe te Autoritetit Portual te Durrësit

(

Nese detyrat, kompetencat dhe pergjegjessite e Autoritetit Kontraktues dhe Autoritetit Portual te Durrës, i transferohen nje tjetër organi shtetëror permes marreveshjeve legjislativë, kjo agjenci apo institucioni i ri do te zevendesojne Autoritetin Kontraktues dhe Autoritetin Portual te Durrës.

Neni 16

Zgjidhja e Kontrates se Konçesionit

16.1 Zgjidhja e kontrates si pasoje e Forces Madhore

Në rast zgjidhje të Kontratës, gjatë kohëzgjatjes së saj, për shkak të Forcës Madhore, secila Palë do të mbartë shpenzimet dhe kostot e veta.

16.2 Zgjidhja e Kontrates per mospermbushje nga Konçesionari

Ne rast zgjidhje te kontrates per shkak te ndodhjes se nje Rasti Mospermbushje nga Konçesionari, Autoriteti Kontraktues ka te drejte t'i drejtohet gjykates per percaktimin e shumes se dëmshpërblimit dhe kompensimit qe i takon.

16.3 Zgjidhja e Kontrates per deshtim/mospermbushje nga Autoriteti Kontraktues

Ne rast zgjidhje te kontrates per mospermbushje nga Autoriteti Kontraktues ose APD, Konçesionari ka te drejte t'i drejtohet gjykates per percaktimin e shumes se demshperblimit apo kompensimit qe i takon.

16.4 Procedura e Zgjidhjes se Kontrates se Konçesionit

Ne rast se gjate kohezgjatjes se kontrates, ndonjera prej paleve do te pretendoje zgjidhjen e parakohshme te saj per cfaredolloj shkak, ka detyrimin qe ti drejtohet gjykates kompetente me kerkese per zgjidhjen e kontrates dhe nuk do te ndermarre asnje hap apo veprim te njeanshem, ligjor apo administrativ, deri sa gjykata te kete dhene nje vendim te formes se prere per vazhdimesine ose jo te kontrates. Kjo nenkupton faktin se gjate gjithë kohezgjatjes se konfliktit institucional apo gjyqesor mes paleve, kontrata do te vazhdoje te prodhoje efekte rregullisht dhe vazhdimesia e saj do te jete e kushtezuar me dispozitivin e vendimit gjyqesor te formes se prere.

Eventualisht, dhenia nga Gjykata e Larte e nje vendimi pezullimi të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë deri në zgjidhjen e çështjes pranë kësaj gjykate, nderpret procedurat e zgjidhjes se kontrates dhe kjo e fundit mbetet ne fuqi deri ne dhenien e vendimit nga Gjykata e Larte.

16.5 Detyrimet gjate periudhes se perfundimit

Pervec rasteve kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate deri ne daten e perfundimit ose mbarimit, Palet do te vazhdojne te permbushin detyrimet e tyre respektive, per aq sa keto detyrime mund te permbushen, me qellim per te siguruar vazhdimesine e sherbimeve te ofruara per perdoruesit/klientet e Portit. Pala qe nuk do te mund te permbushe keto detyrime, duke sjell pasoja negative tek perdoruesit/klientet, do te kompensoje Palen tjetër per çdo dem apo humbje te shkaktuar.

16.6 Te tjera

Pas marrjes se Njoftimit te Zgjidhjes se Kontrates do te zbatohen *mutatis mutandis* parashikimet e nenit 13.1.5.

16.7 Pasojat e perfundimit

Pavaresisht pasojave apo kerkesave te tjera sipas kesaj kontrate apo Ligjit:

- (i) Konçesionari do te transferoje te gjitha asetet dhe te drejtat si rezultat i mbarimit te Periudhes Konçesionare, apo i zgjidhjes se Kontrates;
- (ii) Autoriteti Kontraktues do te kete te drejte arketoje çdo garanci bankare te leshuar nga Konçesionari per çdo shume qe Konçesionari eshte debitor ndaj Autoritetit Kontraktues.
- (iii) Çdo police sigurimi do te kaloje ne emer te Autoritetit Kontraktues, i cili do te jete i vetmi perfitues prej tyre nese do te jete rasti;

Neni 17

Penalitetet dhe Demet

17.1 Koncesionari do t'i paguaje Autoritetit Kontraktues penalitet per vonese si vijojne:

Themelimi i Shoqerise Koncesionare per Zbatimin e Projektit

Koncesionari do t'i paguaje Autoritetit Kontraktues nje penalitet si vijon per cdo jave vonese te filluar ne te cilen Koncesionari deshton ne themelimin e Shoqerise Koncesionare:

5.000 Leke me fillimin e javes se pare dhe te dyte te voneses;

10.000 Leke me fillimin e javes se trete dhe te katert te voneses;

20.000 Leke me fillimin e javes se peste dhe te gjashte te voneses;

30.000 Leke me fillimin e javes se shtate dhe te tete te voneses;

40.000 Leke me fillimin e çdo jave nga e nenta deri ne te gjashtembedhjeten te voneses;

Shuma maksimale e penaliteteve per keto vonesa do te jete ne total 470.000 Leke.

Pas javes se gjashtembedhjete te voneses, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te zgjidhe kontraten pas njoftimit sipas nenit 19.3.

17.1.3 Penalitete te tjera

Per çdo mospermbushje te detyrimeve kontraktore nga Konçesionari te percaktuara ne nenent 17.1.4, 17.1.5, 17.1.6, 17.2.1, dhe 17.2.2, Pala Mospermbushese do te paguaje per secilin rast mospermbushjeje, nje penalitet ne shumën 10.000 Leke per çdo dite mospermbushjeje nga dita e 1-re deri ne ditën e 60-te te mospermbushjes. Penaliteti do te aplikohet per numrin e diteve te vazhdimit te Rastit duke filluar nga data e mbarimit te Periudhes se Bisedimeve, por jo pertej mbarimit te Periudhes se Ndreqjes. Me mbarimin e Periudhes se Ndreqjes, Pala e cila nuk ndodhet para Rastit te Mospermbushjes i ka te drejte te zgjidhe kontaktin nese mospermbushja vazhdon.

Penalitet si me siper do te jete i detyrueshme per t'u paguar pavaresisht nese Pala tjetër mund te kete kerkuar zgjidhjen e kesaj Kontrate ne perfundim te afateve kohore si me siper per aplikimin e tyre.

Çdo pagese penalitetesh duhet do t'i behet Pala tjetër, brenda 15 (pesembedhjete) diteve nga marrja e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër ne te cilin percaktohen shumat e penaliteteve. Nese Konçesionari nuk paguan keto penalitete te pagueshme prej tij brenda afatit, Autoriteti Kontraktues do te kete te drejte t'i mbaje ato nga Sigurimi i Kontrates. Nese shuma e totale e penaliteteve per t'u paguar nga Konçesionari e tejkalon shumën e Sigurimit te Kontrates, Autoriteti Kontraktues do te kete te drejte t'i drejtohet gjykates lidhur me detyrimin e Konçesionarit per pagimin e tyre.

17.2 Te tjera

Nese Konçesionari, ne çdo kohe, deshton ne pagesen, ose mbajtjen ne fuqi me efekt te plote te ndonje nga prej kerkesave te sigurimit te shprehura ne nenin 11 te kesaj Kontrate, Autoriteti Kontraktues do te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme dhe do te mbaje shpenzimet lidhur me to nga Sigurimi i Kontratës.

Neni 18

Transferimi i TKD ne perfundim te Periudhes se Konçesionit

18.1 Konçesionari, duke filluar nga 6 (gjashte) muaj para perfundimit te Periudhes Konçesionare, do te filloje gradualisht transferimin tek Autoriteti Kontraktues te:

- (i) TKD-se dhe te gjitha asetet e tij do te transferohen te lira nga çdo barre apo pengese;
- (ii) Te gjitha dokumentat, kontratat e lidhura me organizimin dhe administrimin e TKD;
- (iii) te gjitha dokumentat ose materialet teknike, juridike dhe financiare qe lidhen me TKD, siç mund te kerkohen ne menyre te arsyeshme nga Autoriteti Kontraktues.
- (iv) Te gjithë rrjetin dhe sistemet software/kompjuterike dhe liçencat e duhura perfshire ketu te drejtat e pronesise intelektuale te perfshira aty, te perdorura gjate zbatimit te Kontrates se Koncesionit.

18.2 Transferimi i vonuar

Nese, Konçesionari nuk arrin te transferoje te Drejtat Koncesionare ne perfundim te Periudhes Konçesionare, perperjashtuar ato qe i atribuohen Autoritetit Kontraktues, Konçesionari eshte i detyruar:

18.2.1 te vazhdoje permbushjen e te gjitha detyrimeve te tij sipas Kontrates;

18.2.2 te mbledhe dhe administroje per llogari te Autoritetit Kontraktues te ardhurat bruto minus kostot operative dhe detyrimet ligjore qe lidhen me kete veprimtari persa i perket te Drejtave koncesionare per sa kohe qe vonesa e Koncesionarit vazhdon te ekzistojë.

18.3 Ne rast se transferimi i aseteve nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues eshte vonuar per arsye qe i atribuohen Autoritetit Kontraktues, Konçesionari do te vazhdoje te shfrytëzoje Infrastrukturen dhe Sherbimet e Projektit sikur Kontrata te ishte ne ekzekutim e siper duke kryer karshi Autoritetit Kontraktues te gjitha pagesat sipas nenit 8 “Çeshtje Financiare”.

18.4 Risku

Deri ne transferimin e plote te te Drejtave Koncesionare nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues, te gjitha dhe cdo risk i lidhur me TKD do te mbeten me Koncesonarin

Neni 19

Mjetet e riparimit/demshperblimit kumulative

Ushtrimi i te drejtave nga secila Pale per te zgjidhur Kontraten, siç parashikohet ne te, nuk do ta pengojne ate Pale te kerkoje ndonje te drejte tjeter apo mjet riparimi qe mund ta ekzistojë sipas ligjit. Te gjitha mjetet e riparimit/demshperblimit ne dispozicion te Paleve do te jene kumulative dhe moskerkimi apo humbja nga ndonjeri prej mjeteve te riparimit/demshperblimit nga secila Pale nuk do te kufizojë, parandalojë ose konsiderohet heqje dore nga mjetet e tjera te riparimit/demshperblimit.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Kjo Kontrate do te rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me Legjislacionin e zbatueshem. Te gjitha mosmarreveshje e lindura nga ose ne lidhje me kete Kontrate, do te zgjidhen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi i së cilës është i ankimueshëm në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Neni 21

Dispozita te Ndryshme

21.1 Vazhdimesia e Detyrimeve

Çdo veprim ligjor ose e drejte ne favor te ndonjeres Pale sipas kesaj Kontrate dhe gjate Periudhes Konçensionare qe mund te rrjedhe nga çdo akt, mosveprim, dokument, çeshtje ose fakte te perfunduara ose harruara nga secila Pale para mbarimit te Periudhes Konçensionare per shkak te mbarimit te afatit te saj ose si rezultat i parashikimeve te kesaj Kontrate do t'i mbijetoje ne mbarim te afatit te Periudhes Konçensionare apo te zgjidhjes se kesaj Kontrate, por ne çdo rast pa cenuar parashikimet e nenit 18.4 me siper.

21.2 Detyrime te veçuara

Asgje ne kete Kontrate nuk ka per qellim te krijojë nje ortakeri apo perqesim midis Paleve te kesaj Kontrate.

Asnjera nga Palet nuk do te kete autoritetin te kryejë perfaqesime apo te veproje ne emer dhe per llogari te Pales tjeter, perveç parashikimeve te nenit 18.2.2 me siper apo te angazhoje Palen tjeter ne cfaredo menyre.

21.3 Pavarersia e dispozitave

Nese cilado nga dispozitat/nenet e kesaj Kontrate vleresohet si e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme per cfaredolloj arsyeje dhe nga cilado gjykate apo juridiksion kompetent, nje dispozite/nen i tille do te shfuqizohet pa sjellur pasoja per dispozitat qe mbeten. Nese nje dispozite/nen i kesaj Kontrate qe eshte themelore per permbushjen e qellimit te kesaj Kontrate gjykohet se eshte e pavlefshme ne cfaredo shtrirje, Koncesionari dhe Autoriteti do te fillojne menjehere negociatat ne mirebesim per ta rregulluar kete pavlefshmeri.

21.4 Ndryshimet e Kontrates

Kjo Kontrate mund te ndryshohet me marreveshje te shkruar te te dy Paleve.

Secila Pale mund t'i drejtoje Pales tjeter ne çdo kohe gjate Periudhes Konçensionare nje kerkese me shkrim per ndryshim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar. Kerkesa duhet te jete me shkrim, e justifikuar dhe te permbaje fakte dhe rrethana konkrete per arsyet e ndryshimit.

Brenda 30 diteve nga paraqitja e kerkeses pala tjeter duhet te shprehet ne menyre te shkruar ne lidhje me pranimin ose refuzimin e ndryshimeve. Afati 30 ditor perfshin te gjithë negocimin e çeshtjes.

Çdo ndryshim i kesaj Kontrate apo Anekseve bashkelidhur, do te jete pjese perberese dhe e pandashme e kesaj Kontrate.

21.5 Njoftimet

21.5.1 Çdo njoftim, e dhene sipas apo ne lidhje me kete Kontrate do te jete me shkrim, e nenshkuar nga apo ne emer te Pales qe e ben njoftimin dhe do te njoftohet permes dergimit personalisht apo dergimit me poste rekomande, ne adresen e deklaruar nga Pala ne kete Kontrate. Njoftimet nuk do te dergohen me poste elektronike (e-mail). Çdo njoftim i tille konsiderohet i pa kryer.

21.5.2 Çdo njoftim do te konsiderohet se eshte marre (perfshire njoftimin per ndryshimin e adreses si me poshte):

- (i) nese eshte derguar personalisht, konsiderohet e dorezuar te nesermen e dorezimit;
- (ii) nese eshte derguar me poste rekomande, konsiderohet i dorezuar ditën e nënshkrimit të marrësit në librin e postës.

Adresat per njoftime dhe komunikime sipas kesaj Kontrate jane:

Autoriteti Kontraktues:

Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacioneve

Sheshi Skenderbej, Nr. 5

Tirana, Albania

Ne vemendje te: Shkelqesise se Tij, Ministrit

Konçesionari:

Bashkimi i shoqerive “Durrës Kurum Shipping” sh.a dhe Global Liman Islemeleri A.S.

Blv. “Deshmoret e Kombit” Twin Towers, Kulla nr.2, Kati 10

Tirana Albania

Ne vemendje te : z.Zeki Kaya

(Adresa do te njoftohet nga Shoqeria Konçesionare menjehere pas themelimit te saj sipas kesaj Kontrate).

21.6.3 Kopjet dhe Gjuha e Kontrates

Kjo Kontrate hartohet ne 2 (dy) kopje origjinale, ne gjuhen shqipe

AUTORITETI KONTRAKTUES

Emri: _____

Funksioni: Minister

KONÇESIONARI

Emri: _____

Funksioni: _____

Emri: _____

Funksioni: _____